



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 16.05.2024)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan – (çështje e shtyrë e nga mbledhja plenare e datës 02.05.2024 - seanca në orën 11:00).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi<sup>1</sup>.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:19.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Gentiana Muçaj</b>  | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Markelian Koça</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Yllka Rupa</b>      | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>1</sup> Zoti Rusi drejton pikën e parë të rendit të ditës. Më pas mbledhja drejtohet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Llagami.

**10. Emona Muçi**

**(anëtare)**

**Shënim:** Nuk mori pjesë në shqyrtimin e çështjes së parë të rendit të ditës Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.**

**4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**

**6. Arben Lila, përfaqësues të Projektit EU4Justice.**

**8. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës.**

**9. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

**10. {...}, Inspektore jomagjistrate pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në sallë).**

**12. {...}, avokate (në sallë).**

#### **RENDI I DITËS:**

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan – (çështje e shtyrë e nga mbledhja plenare e datës 02.05.2024 - seanca në orën 11:00).

**Ilir Rusi:** Përshëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas njoftimit të bërë dhe për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm deklaroj të hapur mbledhjen e ditës së sotme datë 16.05.2024, ora 11:00.

Ju bëj me dije që Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të një takimi institucional, do vijë në vijim të kësaj mbledhjeje.

Duke vazhduar me rendin e ditës, kemi pikën e parë të saj, që është zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksionin gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, - çështje e shtyrë e nga mbledhja plenare e datës 02.05.2024.

Ftoj administratën të bëjë njoftimin e palëve.

*(Futen në sallën e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...} dhe avokatja znj. {...}.)*

***Ilir Rusi:*** Përshëndetje!

Në vijim të kësaj seance dëgjimore, prezent në sallë është znj. {...} e cila sipas autorizimit {...}, datë 30.04.2024, me detyrë inspektore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që të përfaqësojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor të filluar ndaj magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan – prezent.

Në vijim të e-mailit të bërë nga zonja {...}, jemi bërë me dije që është pajisur me prokurë për ta përfaqësuar në këtë procedim disiplinor avokatja {...}, e cila është prezent dhe prokura e saj ju është vënë në dispozicion. Në referim të kësaj seance dëgjimore, sipas përcaktimeve të nenit 142 të ligjit përkatës, do ftoja përfaqësuesen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me qëllim që të paraqesë parashtrimet përkatëse.

Shkurtimisht sepse me shkrim na e keni paraqitur.

*{...}*: Të nderuar anëtarët të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me vendimin 385/1, datë 07.02.2024 ka vendosur: Fillimin e hetimit disiplinor me...

*Ilir Rusi:* Zonja {...}, ju lutem, në mënyrë të përmbledhur, sepse anëtarët i kanë në dispozicion, sepse juve i keni paraqitur prej kohësh.

*{...}*: Po, vetëm fillimin, vendimin e fillimit.

Në analizë të të gjithë elementëve juridikë dhe faktikë ka rezultuar se gjyqtarës {...} me vendimin penal nr. 45, datë 04.07.2023, nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të korrupsionit pasiv të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe është dënuar me 3 vjet burgim. Përfundimisht me 2 vjet burgim, dhe në aplikim të nenit 35, paragrafi i parë i Kodit Penal është dënuar me pjesën e mbetur në bazë të nenit 59, me pezullimin e ekzekutimit të këtij dënimi, si dhe i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike. Ky vendim i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit.

Nga përmbajtja e të dy vendimeve rezulton se ndodhemi përpara plotësimit të dy kushteve kumulative, ku gjyqtari është dënuar me vendim të formës së prerë dhe gjyqtari është dënuar për kryerjen e një krimi.

Duke iu referuar të gjitha akteve të mësipërme dhe nga analiza e fakteve të konstatuara rezulton se në bazë të nenit 104 të ligjit mbi statusin 96/2016. Shkelja disiplinore në rastin konkret përbën shkelje shumë të rëndë disiplinore.

Për sa më sipër, meqenëse jeni njohur me raportin, duke mbajtur në konsideratë se masa disiplinore është e varur nga ekzistenca e përgjegjësisë disiplinore, përfundimisht kërkojmë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të administrojë provat e paraqitura nga ana e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë në këtë procedim disiplinor dhe në mbështetje të nenit 105, pika 1, shkronja “dh”, nenit 111, pika 1, shkronja “b” të ligjit “Për statusin”, të ndryshuar, të vendosë: Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistrates znj. {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe neni 104 i ligjit 96/2016 dhe caktimin ndaj magistrates {...} të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”.

Këto janë parashtrësat shkurt të paraqitura nga ana e Inspektoratit të Drejtësisë.

**Ilir Rusi:** Faleminderit zonja {...}, me cilësinë e përfaqësueses së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sikundër ju bëra me dije verbalisht por edhe nëpërmjet akteve përkatëse, si përfaqësuese e zonjës {...} do jetë avokatja znj. {...} e cila është pajisur me prokurën e posaçme dhe në referim të përcaktimeve ligjore, do t'i jepja fjalën zonjës {...} për parashtrësat e saj dhe për qëndrimin e saj lidhur me këtë moment procedural që është ky procedim disiplinor.

**Av.{...}:** Faleminderit i nderuar zoti Kryetar!

I nderuar z. Kryetar!

Të nderuar anëtarë të KLGJ-së!

Siç shihet edhe nga prokura unë jam kontaktuar nga e përfaqësuarja prej meje vetëm ditën e djeshme, në datë 15.05.2024. Nuk jam njohur fare me aktet e dosjes, me provat e sjella nga ILD-ja për procedimin e të përfaqësuarës prej meje, {...}. Lutem, kërkoj kohë për t'u njohur me këto akte, për të marrë kopje të akteve dhe për të më caktuar një datë tjetër për t'u paraqitur për ta përfaqësuar dhe parashtruar pretendimet e saj.

**Ilir Rusi:** Atëherë, sikundër rezulton dhe parashtrohet, zonja {...} nuk është prezent dhe përfaqësohet nga avokatja e vet. Do t'i kërkoja të paraqiste licencën dhe NUPT-in përkatës pranë institucioneve përkatëse. Njëkohësisht, në lidhje me qëndrimin tuaj të mëtejshëm për vijueshmërinë e këtij procedimi disiplinor, do kërkoja edhe një mendim të zonjës {...}. Çfarë mendoni në këtë moment? Përpara se Këshilli të tërhiqet për të diskutuar.

{...}: Duke qenë se ndodhemi përpara faktit që përfaqësuesja e subjektit të hetimit disiplinor kërkon kohë për t'u njohur me këto akte dhe prokurën e ka me datën e djeshme, mendojmë shtyrjen e seancës dhe pajisjen me të gjithë dokumentacionin e

kërkuar nga mbrojtja për pjesën që disponon KLGJ-ja, pasi ILD-ja ia ka dërguar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

***Ilir Rusi:*** Faleminderit!

Keni ndonjë diskutim për sa janë prezent?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, do ftoja palët të largohen pak, me qëllim që Këshilli të vijojë me diskutimet mbi këto kërkesa të bëra nga ana e tyre.

*(Largohen nga salla e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...} dhe avokatja znj. {...}.)*

***Ilir Rusi:*** Në vijim të kësaj seance dëgjimore, në lidhje me këtë procedim disiplinor, anëtarët u bënë me dije për faktin që zonja {...} do përfaqësohet prej ditës së djeshme nëpërmjet një prokure nga avokate znj. {...}. Njëkohësisht bëri kërkesë për të kërkuar shtyrjen për t'u njohur me aktet që kanë lidhje me këtë procedim disiplinor. Një qëndrim i tillë në lidhje me shtyrjen pozitivisht ishte edhe nga përfaqësuesja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për t'i dhënë kohë.

Në vijim të këtij procedimi disiplinor bëhet me dije fakti që këto prova, këto akte që disponohen janë bërë me dije zonjës {...}, megjithatë marrim përsipër për t'ia vënë në dispozicion edhe avokates e cila ta përfaqësojë në këtë procedim disiplinor.

Meqenëse kërkohet shtyrja, po vazhdoj në lidhje me propozimin e datës nëse jeni dakord për shtyrjen, që të jetë data 29 maj 2024, ditë e mërkurë, ora 10:00, për të vijuar seanca dëgjimore, gjithmonë nëse jeni dakord për shtyrjen. Nëse jeni dakord për shtyrjen, në eventualitet të shtyrjes, si datë e seancës së radhës do të jetë data 29 maj 2024, ora 10:00. Keni diskutime?

Nëse nuk keni diskutime, ky propozim u bë nga ana ime jo si drejtues i seancës por si relator i çështjes, meqenëse nuk kishte diskutime nga kolegët.

***Irena Plaku:*** Dakord.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Për ekonomi kohe, ftoj palët që t'i komunikoj vendimin.

*(Futen në sallën e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...} dhe avokatja znj. {...}.)*

**Ilir Rusi:** Në vijim të këtij shqyrtimi të procedimit disiplinor, Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke marrë në vlerësim kërkesat e avokates përfaqësueses së znj. {...}, por edhe qëndrimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vendosi shtyrjen e seancës dëgjimore dhe seanca e radhës do të jetë në datë 29 maj 2024, ditë e mërkurë, ora 10:00 dhe njëkohësisht megjithëse i kemi vënë në dispozicion aktet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, zonjës {...}, do t'ju vihen në dispozicion edhe juve si avokate të gjitha aktet që disponohen dhe janë pjesë e kësaj dosjeje.

Mund të largoheni!

*(Largohen nga salla e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...} dhe avokatja znj. {...}.)*

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 16.05.2024)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2022”, relator znj. Yllka Rupa. (gjyqtari është shprehur dakord me raport vlerësimin dhe gjithashtu ka shfaqur dëshirën për të qenë prezent në mbledhje).

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami<sup>2</sup>.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:19.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                    |                   |
|--------------------|-------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare)        |
| 2. Ilir Rusi       | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar)          |
| 4. Fatmira Luli    | (anëtare)         |
| 5. Irena Plaku     | (anëtare)         |
| 6. Gentiana Muçaj  | (anëtare)         |

<sup>2</sup> Zoti Rusi drejton pikën e pare të rendit të ditës. Më pas mbledhja drejtohet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Llagami.



7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Markelian Koça*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Arben Lila, përfaqësues të Projektit EU4Justice.*
7. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
8. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës.*
9. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2022”, relator znj. Yllka Rupa. (gjyqtari është shprehur dakord me raport vlerësimin dhe gjithashtu ka shfaqur dëshirën për të qenë prezent në mbledhje).

*(Futet në sallën e mbledhjes Kryetarja e Këshillit znj. Llagami, për të drejtuar seancën plenare në vijim.)*

*(Futet në sallën e mbledhjes edhe magjistrati z. {...}).*

**Naureda Llagami:** Viojmë mbledhjen plenare. Sipas axhendës, sipas rendit tashmë kemi për të marrë në shqyrtim projektraportin për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për vitin 2022, projektraport i cili është hartuar nga relatorja znj. Yllka Rupa. Prezent në fakt kemi edhe magistratin z. {...}. Thjesht për t’ju njohur mbi procedurën.

Fillimisht i jepet fjala relatores e cila shkurtimisht pasi Këshilli është vënë në dijeni mbi përmbajtjen e raportit, shkurtimisht sqaron gjetjet e raportit dhe propozimin përkatës, më pas i kalon fjala magistratit dhe pasi edhe magistrati jep sqarimet e tij mbi projektraportin, fjalën e ka më tej Këshilli i cili merr vendimmarrje mbi sa vlerësohet.

Kështu që pa humbur kohë dëshiroj t’ia jap fjalën zonjës Rupa.

**Yllka Rupa:** Faleminderit Kryetare!

Të nderuar kolegë!

I nderuar zoti {...}!

Në cilësinë e relatores paraqes projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarin i cili ka për qëllim vlerësimin e shkallës së aftësisë së tij në drejtim të etikës dhe veprimtarisë profesionale. Procedura e vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarin {...} ka filluar me vendimin nr. 325, datë 14.06.2023 të Këshillit “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2022”. Kjo procedurë ka kaluar të gjithë hapat që parashikon ligji. Kështu që referuar analizës së të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit, propozimi për nivelin e vlerësimit për të katër kriteret e vlerësimit është si më poshtë:

Lidhur me “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, 1.A Njohuritë ligjore.

1-A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, ka rezultuar se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të paraqitjes dhe analizës të qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, duke i integruar dhe me një analizë të detajuar të provave. Evidentohen aftësitë e tij në lidhje me identifikimin dhe përcaktimin e ligjit të zbatueshëm, duke referuar ose cituar në përmbajtjen e

10

vendimit dispozitat ligjore procedurale dhe materiale. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë për këtë tregues, pikët 25.

Për të kaluar tek 1-A-b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, rezulton gjithashtu se edhe në këtë tregues ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural, apo në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Po ashtu, në shumicën e vendimeve burim vlerësimi evidentohet kujdesi i shtuar i gjyqtarit për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës. Propozohet nivel shumë i lartë vlerësimi, pikët 25.

1.B Lidhur me arsyetimin ligjor. Në të tre komponentët që vlerësojnë dhe pikëzojnë këtë tregues, gjyqtari është vlerësuar në nivelin shumë të lartë. Pikët maksimale, pasi vërehet që gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit 1-B-a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit. Ka aftësi shumë të mira sa i takon një strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit gjyqësor. Gjithashtu rezulton që gjyqtari ka aftësi shumë të larta në lidhje me treguesin 1-B-c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik. Në vendimet e analizuara evidentohet kujdes i shtuar i tij për të nxjerrë në mënyrë të qartë thelbin e konfliktit objekt gjykimi.

Propozimi për nivelin e vlerësimit lidhur me “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, propozohet të jetë niveli "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për të kaluar tek “Aftësitë organizative të gjyqtarit”. Ky kriter vlerësohet sipas treguesve 2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë dhe 2.B për të kryer procedura gjyqësore. Për sa i përket 2.A.a Respektimi i afateve ligjore, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari ka gjykuar në total 216 çështje, për të cilat ligji parashikon afat ligjor. Në projektraportin e vlerësimit janë pasqyruar në mënyrë të detajuar çështjet e gjykuara në tejkalim të afatit ligjor. Në bazë të një analize matematikore dhe logjike, sipas parashikimeve të metodologjisë së vlerësimit, për të shmangur përfundimet për çështje, që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, ka rezultuar se 23.6% e çështjeve janë shqyrtuar jashtë afatit ligjor. Këto çështje përbëjnë 10% të

çështjeve të shqyrtuara nga gjyqtari në total. Sipas metodologjisë së vlerësimit kjo përqindje pikëzohet me 9 pikë, por duke vlerësuar shkaqet që kanë çuar në tejkalimin e afateve të cilat janë parashtruar edhe nga gjyqtari në raportin e vetëvlerësimit dhe që kanë të bëjnë me ngarkesën në punë, kompleksitetin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve. Përgjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari ka gjykuar në total 501 çështje ose 43 % të tyre me afat ligjor. Propozoj që ky tregues të pikëzohet me 15 pikë.

Për sa i takon 2.A.b Standardeve minimale kohore, numri total i çështjeve të gjykuara nga gjyqtari, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor është 284. Nga analiza e të dhënave të dala nga burimet e vlerësimit, rezulton se 13.3% e çështjeve janë gjykuar jashtë standardit. Referuar metodologjisë, kjo përqindje pikëzohet me 4 pikë. Por duke vlerësuar ato rrethana të cilat nuk varen nga gjyqtari, të cilat janë të detajuara në projektraportin e vlerësimit, propozohet niveli maksimal i vlerësimit lidhur me këtë tregues.

Për sa i takon 2.A.c Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, nga analiza e të dhënave rezulton se kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara është më e shkurtër se standardi minimal kohor për shumicën e kategorive të çështjeve, në metodologjinë e pikëzimit parashikohet një analizë logjike lidhur me vlerësimin e këtij treguesi. Kështu që analiza e të dhënave statistikore është bërë duke pasur në konsideratë edhe kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve; dhe duke vlerësuar këto komponentë, propozohet niveli i vlerësimit me 5 pikë lidhur me këtë tregues për gjyqtarin.

Për sa i takon 2.A.ç Rendimentit të përfundimit të çështjeve gjyqësore, referuar burimeve të vlerësimit, në total, duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara nga gjyqtari, pavarësisht kohës së caktimit të tyre (janë 572) me numrin e çështjeve gjyqësore që ka shqyrtuar brenda vitit kalendarik (janë 501), rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore në total është 87.6%. Referuar metodologjisë së vlerësimit, të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, dukë pasur në konsideratë se gjyqtari ka tejkaluar me 50% standardin minimal të ngarkesës

së përcaktuar, është vlerësuar dhe propozoj që pikëzimi i këtij treguesi të jetë në nivelin e 10 pikëve.

Për sa i takon 2.A.d Kohës mesatare të arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të veçantë që të respektojë afatet dhe vetëm në 4 nga 14 kategoritë rezulton që ky afat të jetë tejkaluar. Duke pasur parasysh numrin e madh të çështjeve të shqyrtuara nga ana e gjyqtarit 501 çështje për gjithë periudhën e vlerësimit, propozoj që lidhur me këtë tregues të pikëzohet në nivelin e 15 pikëve.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore. 2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, ka rezultuar sipas burimeve që numri mesatar i seancave gjyqësore për të gjitha kategoritë është 1.1 seanca dhe shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproduktive është e lartë, prandaj gjyqtari vlerësohet me 15 pikë.

Për sa i takon 2.B.b Kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, rezulton se gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, gjithashtu duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, gjë e cila konstatohet lehtësisht pasi pjesa më e madhe shqyrtimeve janë përfunduar me një seancë të vetme si dhe ka marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet, duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse dhe duke shmangur seancat joproduktive. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 20.

Në lidhje me 2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore. 2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes, paraqitet në nivel shumë të mirë. Propozohet niveli i pikëzimit me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes, propozohet niveli i vlerësimit mbi mesatar duke qenë se mungon letra e të drejtave (standard i mbajtur tashmë nga Këshilli).

Kështu që, propozimi për nivelin e vlerësimit lidhur me kriterin “Aftësitë organizative të gjyqtarit”, propozohet të jetë niveli "Shkëlqyeshëm", pikët 98.

Në lidhje me “Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale”, për të gjithë treguesit e këtij kriteri, gjyqtari është vlerësuar në nivelin shumë të lartë, pikët maksimale pasi rezulton se reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjes së pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo çështje tjetër që cenon integritetin e gjyqtarit. Gjithashtu rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk përdorur gjuhë diskriminuese në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet në procedim ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Gjithashtu referuar burimeve të vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna për numër tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Propozohet lidhur me kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për të kaluar tek kriteri i fundit “Aftësitë profesionale dhe angazhimi profesional”, për sa i takon aftësive të komunikimit, gjyqtari paraqet komunikim të qartë dhe transparent, respekton konfidencialitetin dhe mbron të dhënat personale. Ka aftësi shumë të mira për të bashkëpunuar si në aspektin e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët ashtu edhe të bashkëpunimit me administratën gjyqësore. Për të gjithë këta tregues është vlerësuar në nivelin maksimal të pikëzimit.

Për sa i takon 4.C Gatishmërisë së gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera. 4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, gjyqtari rezulton të ketë marrë pjesë në aktivitete trajnuese, gjithsej 2 aktivitete të zhvilluara për 3 ditë në Shkollën e Magjistraturës, si dhe është pjesëmarrës në aktivitetin, një takim të përvitshëm të Shoqatës Ndërkombëtare të magjistratëve, të zhvilluar në Tel-Aviv. Objekti i këtij eventi është trajnimi i gjyqtarëve pjesëmarrës.

Pra në tre këto aktivitete të konvertuara në ditë, përbëjnë në total 8 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve të parashikuar në shkronjën “a”, pika 3 e nenit 5 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Propozohet niveli i vlerësimit me 20 pikë, lidhur me këtë tregues.

Për sa i takon 4.C.b Disponueshmërisë së gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, provohet të ketë dhënë kontribute lidhur me këtë tregues. Propozohet niveli i vlerësimit me 5 pikë.

Po ashtu edhe 4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, provohet me një dokument. Është pjesëmarrja e gjyqtarit në një takim të organizuar në 2022 (18 nëntor), në Universitetin e Peruxhias me temë: “Dialog ndërmjet kulturave juridike. Autonomia dhe independenca e magjistratëve”, ku rezulton të ketë qenë në panelin e folësve. Propozohet niveli i vlerësimit lidhur me këtë tregues me 5 pikë.

Nuk ka publikime akademike dhe ligjore kështu që nuk vlerësohet për treguesin e fundit.

Kështu që propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, propozohet të jetë niveli "Shkëlqyeshëm", pikët 95.

Propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit për gjyqtarin propozohet të jetë "Shkëlqyeshëm", pikët 393.

Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit zonja Rupa!

Atëherë, fjalën ia jap magjistratit z. {...}, nëse ka ndonjë, megjithëse me shkrim nuk na ka dërguar, por meqë ka ardhur prezent në seancë, pse jo, nëse ai ka ndonjë kundërshtim, sqarim, për sa dëgjoji.

{...}: Faleminderit zonja Kryetare!

Faleminderit znj. Yllka, relatores për projektvendimin për vlerësimin tim.

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Është e vërtetë se unë nuk kam paraqitur asnjë koment apo asnjë kundërshti në lidhje me draft vendimin për vlerësimin tim. Në përgjithësi e konsideroj të drejtë dhe dëshiroj të falënderoj të gjithë ata që janë bërë pjesë e përgatitjes së këtij drafti, me këshilltarët, specialistët tuaj dhe relatoren.

Kam disa opinione që nuk janë vetëm të miat, por shfrytëzova sot rastin, nëse edhe ju ma jepni, që janë të diskutuara me të gjithë kolegët tanë edhe në takime informale, por edhe në takime formale, që kemi bërë si shoqatë, që disa elementë të asaj rregulloreje që ju zbatoni për vlerësimin e gjyqtarëve, ndoshta ka ardhur koha sot të ndryshojnë. Gjithashtu ka edhe disa elementë edhe vetë ligji të cilët ka ardhur koha të ndryshojnë. Nuk është tabu, e kam thënë edhe më parë, që të ndryshojmë disa nga ligjet që janë në themel të sistemit gjyqësor. Mendojmë, dhe këtë e flas edhe në emër të këtij grupimi që unë drejtoj, që është më i madhi dhe i vetmi, (të gjithë grupimet e tjera, mbledhjet e tjera mund të jenë mbledhje), por besoj se i vetmi vend ku mund të shtrohen për zgjidhje problemet e gjyqtarëve është Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe shoqata e gjyqtarëve. Të gjithë të tjerët pastaj besoj se i tejkalojnë kompetencat e tyre. Dhe duhet të reagoni edhe ju si Këshill për të vendosur në vend edhe autoritetin tuaj të cenuar ndonjëherë në raste të tilla. Ne kemi reaguar edhe për ju, por duam që edhe ju të flisni për veten tuaj. Po flisja për ato elementë. Ne kemi bërë një detajim të të gjithë problematikave, do të dëshironim që të kishim edhe një takim të përbashkët me ju, për të diskutuar më mirë sistemin. Nuk diskutohet sot për {...}. Unë kam 23 vjet gjyqtar. Jam munduar ta bëj detyrën me korrektesë. Gjatë jetës sime profesionale jam përballur me shumë sfida nga më të vështirat. Me ndihmën e Zotit dhe të familjarëve të mi që më kanë mbështetur, edhe timen, kam arritur t'i tejkaloj dhe kjo më ka mbushur akoma më shumë me përgjegjësi për të shpërblyer atyre njerëzve që kanë besuar tek unë dhe ndjej që duhet të vazhdoj akoma se kujtova se i kisha mbaruar disa beteja të miat, por duhet të vazhdoj akoma për të mirë të sistemit.

Kam dëgjuar që ... tek rregullorja nuk mund të ndryshojë, sepse kemi bërë praktika, ka praktika të mëparshme. Çdo gjë ndryshon. Dinamike është çdo gjë. Madje për mua është guxim dhe është zgjuarsia që me kalimin e një kohe të caktuar kur ne



shikojmë që ka probleme, i ndryshojmë. Në mënyrë të përmbledhur këtu dëshiroj që të shpreh që të t'i jepet më shumë përparësi, së pari, karrierës së gjyqtarëve/magjistratëve, që të jetë element thelbësor, të jetë element shumë i rëndësishëm për promovimin e magjistratëve sepse nuk na duhen vetëm njerëz që dinë mirë apo kanë njohur të theksuara për ligjin sa kanë mbaruar në bankat e shkollës, por na duhen njerëz që kanë edhe një përvojë jetësore. Tashmë ne e dimë që jemi shumë pak.

Së dyti, duhet vënë theksi tek profilizimi. Nga ç'kam konstatuar, Këshilli në qëndrimin tonë ka mbajtur një qëndrim të gabuar sa i përket promovimit apo klasifikimit të magjistratëve për shkak të profilizimit. Keni bërë një lloj diskriminimi që nuk është normal, flas për gjyqtarët që janë gjyqtarë civilistë, i keni dhënë përparësi më shumë se gjyqtarët që janë gjyqtarë penalistë. Një gjyqtar civilist sot ka të drejtë të aplikojë për ngritje në detyrë në dy drejtime, edhe në penale edhe në civile. Një gjyqtar penalist, jo për fajin e vet, është i detyruar të kandidojë vetëm për gjykatën penale. Në qëndrimin tim, por besoj edhe të gjithë ju e ndani, kur flet ligji për profilizim në të drejtë penale, do të thotë që gjyqtari është marrë me penale në të gjithë jetën. Bërja e relacioneve në Gjykatë të Lartë për çështje penale apo gjykimi i masave të sigurimit të një gjyqtari civil, nuk konsiderohet si një përvojë në fushën penale dhe unë ju ftoj që këto gjëra, ato që mundet ju t'i ndryshoni, t'i ndryshoni sa më shpejt pa u bërë objekti i padive gjyqësore sepse edhe pse unë kam bërë padi kundër Këshillit, e konsideroj se është mjete i fundit. Ne kemi mundësi që të merremi vesh me njëri-tjetrin sepse jemi kolegë, sot jeni ju këtu, nesër do jenë disa të tjerë, unë kam qenë përpara jush. Është përgjegjësi shumë e madhe dhe unë e di se çfarë vështirësish keni dhe unë jam shumë mirënjohës për të gjithë punën që bëni. Por disa gjëra që janë për t'u ndryshuar, unë ju lutem t'i ndryshoni, mos ta lëmë sistemin që të përballet nëpër gjykata dhe të bëhemi objekt i disa gjërave që mund t'i rregullojmë me njëri-tjetrin. Unë mendoj se kështu secilit do t'i jepni atë që i takon. Nuk po flas vetëm për veten time personalisht, edhe pse mund të jem subjekt i njëjës prej garave. Përrjashtojeni {...}. Flasim për të ardhmen. Çfarë duam të ndërtojmë? Duam të ndërtojmë një sistem të shëndoshë apo jo? Duam të ndërtojmë në penale një sistem të shëndoshë që

të kemi penalistë. Duam të ndërtojmë në civile dhe të çojmë gjyqtarë që kanë përvojë. Duam të shkojmë në administrative.

Ja për shembull unë kam konkurruar edhe në Gjykatën Administrative të Apelit për shkak të ligjit. Por nëse më vjen dikush përballë, një person që ka vite më shumë se mua, do të më vijë turp. Ata që më njohin, e dinë që unë i pranoj gjërat dhe kam guxim të them faleminderit, nuk mund të vazhdoj, (më fal Genta se po të marr për shembull) se është Genta para meje se ka shumë vite që jep kontribut në atë fushë. Kështu duhet të ndodhë edhe në penale, kështu duhet të ndodhë edhe në civile.

Edhe një herë më falni se ndoshta u zgjata.

Sa i përket ndryshimeve që kanë të bëjnë në ligj, së bashku ne mund t'ia dalim që të detyrojmë ligjvënësin, më sa shoh edhe atij i kanë ardhur në mend (ligjvënësit), për të bërë ato ndryshimet. Por duhet të jemi bashkë, mos të lejojmë njerëz të caktuar që për interesa të caktuara të vogla, njerëz që së pari duhet të kërkonin falje për sjelljen e sistemit në këtë pikë, sot dalin e flasin për problematika të sistemit. Nëse unë kam bërë një gabim, nuk kam kurajë, nuk kam sy e faqe të dal përpara të tjerëve dhe të them shiko duhen bërë, sepse kam qenë unë ai që e solla në këtë pikë.

Ju faleminderit!

**Naureda Llagami:** {...} shumë faleminderit!

Në fakt na bërë të reflektojmë si Këshill, jo se ne nuk kemi reflektuar, dhe jemi gjithmonë të hapur. Bërë shumë mirë që erdhe dhe që na i the këto gjëra. Midis nesh ne i kemi të gjithë këto shqetësime dhe ndoshta ka ardhur ai momenti i duhur ku ne edhe të bëjmë disa veprime më shumë. Nga ana e Këshillit, pa diskutim Këshilli është shtëpia juaj. E kam deklaruar në shumë evente, në shumë takime, që kam ardhur edhe tek shoqata juaj: Po s'erdhët këtu, ku do shkoni?! Po s'bëmë ne për ju, kush do bëjë?! Kështu që unë marrë iniciativën që po, le t'i shohim gjërat. Çfarë janë gjëra të rregullores, le ta rishikojmë rregulloren. Ka ardhur momenti dhe për t'i bërë një vlerësim; dhe çfarë janë çështje të ligjit, pse jo bashkë t'i propozojmë nëse ju si trupë gjyqësore mendoni se ka një lloj joproporcionaliteti në vlerësimin e gjyqtarëve. Kështu që, nga ana e Këshillit keni

të gjithë dashamirësinë. Mund të fillojmë që nga java tjetër apo javët në vijim, të lejmë një orar këtu në Këshill, të mblidhemi të gjithë bashkë, të shohim çfarë nuk shkon dhe çfarë është problematikë tek ne dhe ta sistemojmë, për të mirën tuaj. Kështu që nga ana e Këshillit keni të gjithë mbështetjen për ta nisur këtë proces, për aktet tona, kuptohet, jemi më fleksibël, sepse janë akte që ne i miratojmë vetë, por për ato gjëra që i ka ligji pse jo dhe t'i shohim dhe të bëjmë propozime përkatëse.

Fjalën e deshi edhe zoti Toro. Ndjesë Alban, se...!

***Alban Toro:*** Jo, s'ka gjë! S'prish punë!

Faleminderit!

Atëherë, pavarësisht se me këtë diskutim dalim pak jashtë objektit të axhendës të cilën jemi mbledhur, gjithsesi unë e shikoj të nevojshme që të gjithë shqetësimet e gjyqtarëve të adresohen në të vetmin institucion i cili është i aftë dhe ka kompetencë të marri vendimmarrje të tilla, të cilat do të lehtësojnë punën e tyre.

Natyrisht nuk jam për gjykimin “alla byro politike”, që rëndomtë i dëgjojmë majtas, djathtas, por jam për mbledhje, diskutime sepse vetëm në bazë të kësaj ne kuptojmë se kush ka të drejtë dhe arrijmë tek drejtësia.

Në lidhje me aktet normative të cilat ne kemi miratuar në lidhje me vlerësimin e gjyqtarëve, më lejoni t'ju kujtoj që, që në krye të herës kur kemi nxjerrë këtë akt, ne kemi kërkuar nga gjyqtarët, dhe unë vazhdimisht kërkoj nga KLGJ-ja për t'ia çuar gjyqtarëve, çdo akt i cili prek punën e tyre të përditshme. Në rastin konkret, për këtë akt nënligjor, pak kush, për të mos thënë askush, ka kontribuar për ta përmirësuar në ato burime vlerësimi që ligji ka përcaktuar në rastin konkret. Nëse këto burime janë të gabuara dhe eksperiencën e kanë të copëtuar në shumë komponentë dhe nuk i japin zë të veçantë, në fakt duhet të ishte e tillë, që eksperiencia në punë duhet të kishte një vlerë shumë të shtuar (jo të shtuar, por shumë të shtuar), ndërkohë që atë e kanë copëtuar në komponentë të caktuar duke pretenduar që si një gjyqtar me eksperiencë të madhe, nëse jep, këta komponentë e nxjerrin në pah, ashtu sikur dikush ka një eksperiencë të vogël, gjithsesi do ta vendosja theksin tek mosngurrimi për t'iu drejtuar KLGJ-së, për të kërkuar debate

19

---

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor  
Tiranë, më 16.05.2024 (Pika 2)***

për çështje të caktuara sepse në fund të fundit këto janë kolegët tuaj (janë gjashtë). Dhe nëse ju nuk e bëni këtu, nuk e di në cilin institucion tjetër mund të bëhet, qoftë edhe institucione “ad hoc”, qoftë edhe institucione të byrosë politike, por që për fat të keq ligji ka përcaktuar të vetmin institucion i cili do diagnostikojë problemin, do ta riparojë, mbetet Këshilli i Lartë Gjyqësor. Kështu që në këtë kontekst, ju jeni të hapur të kërkonit debate, mbledhje. Ne jemi të hapur të mblidhemi, të diskutojmë bashkë me ju, se në fund të fundit kërkojmë një sistem drejtësie formidabël/perfekt dhe mundësisht brenda këtij sistemi të mos ketë individ i cili njollos ose kalb më pas sistemin duke detyruar pastaj ligjvënësin e mençur të bëjë reforma të tjera, të cilat kanë një kosto të caktuar.

**Naureda Llagami:** Shumë faleminderit z. Toro!

Atëherë, për ta mbyllur këtë diskors, unë mendoj që nga shoqata, në çdo moment mund të sillni një kërkesë për çështjet që ju mendoni dhe mund të lejmë më pas një takim të përbashkët me Këshillin dhe të diskutojmë dhe pse jo të reflektojmë mbi ato që ju keni nevojë. Dakord?

Shumë faleminderit! Tani mund të vazhdoni, për të lejuar Këshillin të vijojë me procesin e vendimmarrjes. Faleminderit për prezencën!

*(Largohet nga salla e mbledhjes gjyqtari z. {...}.)*

**Naureda Llagami:** Atëherë, kemi ndonjë gjë?

Atëherë, nëse nuk kemi diskutim, kalojmë në miratimin e projekt-aktit?

Votim!

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Emona Muçi*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë miratohet raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarit {...}, për vitin 2022. Niveli i përgjithshëm i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”. Gjithsej pikët 393.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 16.05.2024)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, relatore znj. Yllka Rupa.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami<sup>3</sup>.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:19.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Gentiana Muçaj</b>  | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>7. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |

<sup>3</sup> Zoti Rusi drejton pikën e parë të rendit të ditës. Më pas mbledhja drejtohet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Llagami.

- |                       |                  |
|-----------------------|------------------|
| <b>8. Alban Toro</b>  | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>9. Yllka Rupa</b>  | <b>(anëtare)</b> |
| <b>10. Emona Muçi</b> | <b>(anëtare)</b> |

**Shënim:** Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Markelian Koça**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Arben Lila, përfaqësues të Projektit EU4Justice.**
- 7. Valbona Bala, eksperte EWMI.**
- 8. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës.**
- 9. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, relatore znj. Yllka Rupa.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kemi çështjen tjetër e cila edhe kjo ka të bëjë me një raport vlerësimi etik dhe profesional, bëhet fjalë për Entela Shedulën, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016. Relatore është sërish zonja Yllka Rupa. Nuk ka kundërshtime, të paktën sa kemi informim të procedurës. Kështu që zonja Yllka

23

shkurtimisht vetëm me gjetjet përfundimtare të raportit për të lejuar Këshillin për të marrë vendim.

***Yllka Rupa***: Faleminderit!

Zonja {...} vlerësohet për periudhën tetor 2013 – tetor 2016 (gradimi i gjyqtares). Procedura e vlerësimit të kësaj gjyqtareje ka filluar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 523, datë 05.10.2023 dhe ka kaluar etapat që ka parashikuar ligji, kështu që unë në mënyrë të përmbledhur po relatoj rezultatet e vlerësimit dhe pikëzimit për gjithsecilin nga katër kriteret e vlerësimit.

Lidhur me “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, për të gjithë komponentët gjyqtarja është vlerësuar në nivelin shumë të lartë, me pikët 25, pasi referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues (1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe konfliktin e normave) rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes si dhe identifikimit të normave konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim.

Lidhur me 1.A.b Aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, referuar të dhënave rezulton se gjyqtarja ka aftësi të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësorë unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës. Propozohet nivel shumë i lartë vlerësimi, pikët 25.

Lidhur me arsyetimin ligjor, për të tre treguesit e këtij komponenti, 1.B.a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit, 1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit, 1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik, gjyqtarja rezulton të jetë në nivele shumë të mira. Propozohet niveli maksimal i pikëzimit. Kështu që lidhur me kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, propozohet niveli "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i takon “Aftësive organizative”, në të dy komponentët: 2A Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë dhe për të kryer procedura gjyqësore (2B), për të gjithë

24



treguesit gjyqtarja është vlerësuar në nivel shumë të mirë. Referuar 2.A.a Respektimit të afateve ligjore, në tërësi rezulton se për këtë tregues gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimeve brenda afateve ligjore. Rezulton që gjyqtarja të ketë respektuar afatin ligjor, prezumohet pra për të gjitha kategoritë e çështjeve. Propozohet niveli i vlerësimit 15 pikë.

Në lidhje me 2.A.b Plotësimin e standardeve minimale kohore, rezulton për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve të analizuara, që rezulton në masën 28.5 %; faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit të cilat, nga dosjet e vëzhguara, nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarës dhe tejkalimin e standardit sasior të zbatueshëm në masën 181 %, janë vlerësuar për të pikëzuar gjyqtaren në nivelin e 5 pikëve.

Për sa i takon 2.A.c Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, duke marrë në konsideratë faktin se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, vetëm për një kategori tejkalohe si dhe duke iu referuar menaxhimit të kohës dhe kryerjes së veprimeve procedurale nga gjyqtarja, vlerësohet se ky tregues duhet të vlerësohet maksimalisht me 5 pikë.

Për sa i përket 2.A.ç. Rendimentit të përfundimit të çështjeve gjyqësore rezulton që rendimenti rezulton në masën 99%, referuar metodologjisë së pikëzimit pikëzohet me 10 pikë ky tregues.

Po ashtu 2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar ka rezultuar më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, propozohet niveli i pikëzimit 15 pikë.

## 2.B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore

Në lidhje me 2.B.a Numrin mesatar të seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive, rezulton që numri mesatar i seancave është më i madh se 3, pra shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproduktive është e lartë, prandaj vlerësohet të pikëzohet me 15 pikë në lidhje me këtë tregues.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, duke iu referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë të lartë në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara. Propozohet niveli i pikëzimit me 20 pikë.

Në lidhje me 2.C Aftësinë e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore, të dy komponentët që pikëzojnë dhe përcaktojnë nivelin e këtij treguesi, pra 2.C.a Rregullshmëria e dosjes dhe 2.C.b Plotësia dhe saktësia e dokumentacionit, propozohet niveli shumë i lartë i vlerësimit. Pikët maksimale.

Kështu që propozimi për kriterin “Aftësitë organizative të gjyqtares”, propozohet të jetë niveli "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për të kaluar tek “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, për të gjithë treguesit e këtij kriteri propozohet nivel shumë i lartë vlerësimi dhe pikëzimi, pasi rezulton se gjyqtarja {...} reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Gjithashtu nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që te dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares. Gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Gjithashtu nuk rezulton një numri tejet të lartë të kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtares.

Propozohet lidhur me kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për të kaluar tek “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”. Në të dy komponentët që pikëzojnë dhe përcaktojnë nivelin e vlerësimit: për aftësitë e komunikimit, gjyqtarja rezulton në nivele mjaft të mira, komunikimi është i qartë dhe transparent; respekton konfidencialitetin dhe mbron të dhënat personale për gjatë kohës që vjen në dijeni për shkak të funksionit me to.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar është në nivel shumë të lartë, si në aspektin e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe të përvojës profesionale me ta, ashtu edhe në aspektin e shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore. Propozohet nivel shumë i lartë pikëzimi dhe vlerësimi.

Për sa i takon treguesit 4.C. Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, provohet se gjyqtarja ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të trajnimeve të Shkollës së Magjistraturës gjithsej 16 aktivitete të zhvilluara për 31 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën trevjeçare të vlerësimit. Propozohet niveli i pikëzimit me 20 pikë.

Për sa i takon 4.C.b Disponueshmërisë së gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë, nuk provohet një gjë e tillë. Pikëzohet me 3 pikë.

Gjithashtu gjyqtarja nuk ka angazhim në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe veprimtari për marrëdhëniet me publikun (4.C.c). Vlerësohet me 3 pikë.

Gjithashtu nuk rezulton të ketë publikime ligjore akademike (4.C.ç).

Në lidhje me propozimin për nivelin e vlerësimit të "Aftësive personale dhe angazhimit profesional", propozohet niveli "Shkëlqyeshëm", pikët 91.

Kështu që propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit të gjyqtares {...} propozohet të jetë niveli "Shkëlqyeshëm", pikët 391.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Keni ndonjë diskutim?

Po!

**Irena Plaku:** Kam unë disa diskutime. Në fakt unë kam disa propozime.

Për sa i përket kriterit të parë të vlerësimit të gjyqtares, konkretisht treguesit të parë (do i marrë me radhë treguesit për të cilët unë kam kundërshtime dhe propozime

përkatëse, duke propozuar një nivel tjetër vlerësimi dhe pikëzimi), konkretisht për treguesin e parë vlerësoj se gjyqtarja duhet të vlerësohet në nivelin mbi mesatar, pasi nga burimet e vlerësimit, konkretisht në të gjitha vendimet burim vlerësimi nuk rezulton që gjyqtarja, domethënë rezulton se gjyqtarja pasqyron rrethanat e faktit por duke integruar në disa raste dhe provat e marra në shqyrtim por kjo nuk vërehet tek të gjitha vendimet burim vlerësimi, pasi në disa vendime parashtrohen rrethanat e fakteve sipas pretendimeve të palëve dhe jo ashtu siç kanë rezultuar nga shqyrtimi gjyqësor. Gjithashtu edhe sa i përket ligjit të zbatueshëm (kjo është në fakt në mënyrë të përmbledhur pa e cituar se cili vendim pasi unë në fakt i kam evidentuar edhe me vendimet përkatëse)...

***Yllka Rupa:*** Është e mira që të thuhet vendimi.

***Irena Plaku:*** Gjithashtu edhe për sa i përket “Ligjit të zbatueshëm”, referohet nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore, rezulton se gjyqtarja citon dispozitat ligjore që gjejnë zbatim, ku tek vendimet civile, tek disa vendime civile evidentohet edhe përmbajtja e këtyre dispozitave, ndërsa tek vendimet penale dhe tek disa vendime të tjera, vetëm citohet neni përkatës, pa u identifikuar përmbajtja e dispozitës e cila është tepër e rëndësishme, sidomos tek dispozitat që kemi të bëjmë me vepra penale, pasi mbi bazë të saj identifikohet cilësimi juridik i saktë i veprës por edhe masa e dënimit për të cilën do dënohet apo është dënuar më pas i pandehuri në gjykim.

Gjithashtu, siç e thashë, mund të shikohet tek vendimet burim vlerësimi që kur dispozitat janë blankete nuk referon ligjet përkatëse por bëhet një referim në përgjithësi. Është një ndër vendimet ku është referuar amnistia, është vetëm cituar neni por jo përmbajtja e dispozitës dhe se si ka gjetur zbatim dhe të jetë analizuar më pas kjo.

Për këtë arsye, për këtë tregues unë vlerësoj se aftësia e gjyqtarës është “mbi mesatare”.

Për sa i përket treguesit “Interpretimi i ligjit”, unë do të veçoja disa vendime gjyqësore, konkretisht tek disa vendime gjyqësore konkretisht që kanë të bëjnë me objekt “pavlefshmërinë e testamenteve”, rezulton se gjyqtarja ka bërë një interpretim të ligjit

si në kuptimin abstrakt të tij para aplikimit mbi faktet e çështjes, ndërsa tek vendimet penale dhe tek disa vendime të tjera civile, ligjet janë vetëm cituar dhe më pas nuk është dhënë kuptimi i tyre, i dispozitës përkatëse, para aplikimit mbi faktet konkrete, por është bërë një aplikim mbi faktet konkrete, në mënyrë tepër të përmbledhur, duke bërë vendimet gjyqësore tepër të thata, konkretisht sa i përket arsytimit ligjor. Tek vendimet penale konstatohet shumë thjesht, pasi gjyqtarja në këtë rast në momentin që, pas parashtrimit të rrethanave të faktit citon nenin përkatës dhe më pas konkludon mbi fajësinë e të pandehurit duke evidentuar më pas katër elementët e veprës penale por pa i arsytuar ato. Për shembull mund të jetë... Në fakt është tek të gjithë dispozitat... thotë është konsumuar ana objektive e veprës penale, pa bërë një arsytim mbi faktet e çështjes; ka plotësuar moshën për përgjegjësi penale, duke thënë që është madhor, pa e identifikuar kush është mosha për përgjegjësi penale, etj.; apo është bërë me dashje, me dashje të tërthortë, pa dhënë një kuptim, pa bërë një interpretim të elementëve përbërës të veprës penale. Kjo është në mënyrë të përmbledhur për sa i përket “Interpretimit të ligjit”.

Në fakt, tek dispozitat procedurale konstatoj se dy vendime, që kanë të bëjnë me “pavlefshmërinë e kontratave”, që në thelb kanë të bëjnë me “njohje pronar”, për mua është referuar gabim dispozita (për mua, për ligjin në fakt), dispozita procedurale, për sa i përket kompetencës, duke iu referuar nenit 42, i ligjit.

Ndërsa për sa i përket treguesit tjetër “Qartësia...”, konstatoj që në të gjitha vendimet gjyqësore, përveçse në një rast, nuk është përcaktuar, në arsytimin e vendimit, masa e dënimit, është përcaktuar vetëm lloji, por pa identifikuar masën konkrete, mënyrën se si do zbatohet në pjesën arsyetuese. Por kjo vetëkuptohet nga vendimi duke arritur vetëm në konkluzionet përkatëse, vetëkuptohet për atë që është shënuar në dispozitiv, pasi, të paktën nga vendimet gjyqësore, konstatohet që gjyqtarja ka dhënë të njëjtën masë dënimi nga prokurori, por duke mos e analizuar dhe duke mos e shprehur këtë në vendimmarrje.

Për këtë arsye unë them që kjo ka të bëjë me qartësinë e vendimit, pasi vendimi në këtë rast është i paqartë, edhe për sa i përket zbatimit apo në rastet kur sendet janë sekuestruar, etj., nuk shënohet.

Një ndër rrethanat të cilat mendoj që ka të bëjë me qartësinë e vendimit është edhe pjesa e dispozitivit të vendimit. Tek një vendim “konstatimi i pavlefshmërisë absolute të një kontrate (të cilën e ka lënë “kontrate”, pa identifikuar)”, mënyra e shprehjes së vendimit është “pavlefshmëria e kontratës” dhe është bërë vetëm ... pa u referuar asaj që është në objektin e padisë, jo atë që ka shkruar pala, por është pasqyruar dispozitivi vetëm sipas objektit të palës, duke mos e strukturuar apo shprehur sipas ligjit mbi pasojat e saj.

Ndërsa në një vendim penal (që unë mendoj që ka të bëjë për “qartësinë”), objekti i akuzës ka qenë për 2 vepra penale. Në dispozitiv gjyqtari është shprehur vetëm për deklarimin fajtor për një vepër penale, kur nga arsyetimi i vendimit kuptohet që e ka përthithur thotë vendimi sepse është nga elementët e veprës penale që mund të përthithet për shkak se është kryer, domethënë ka qenë si vepër penale që ka shërbyer për kryerjen e veprës tjetër penale, konkretisht është “falsifikimi i dokumentave”, por në pjesën e dispozitivit është i paqartë se si është shprehur gjyqtarja “pushim, pafajësi”. Gjyqtarja duhet të shprehet për të gjithë akuzat të cilat janë ngritur në pjesën e dispozitivit.

Për këtë arsye unë propozoj për këtë tregues një nivel “mbi mesatar”, për sa i përket “Qartësisë së vendimit”.

Ndërsa për sa i përket treguesit “Analiza logjike”, edhe për këtë tregues unë propozoj një pikëzim tjetër, në fakt këtu propozoj pikëzimin në nivelin “mbi mesatar”, më fal, në nivelin “mesatar” (kërkoj ndjesë), pasi dispozitat siç e thamë janë cituar, në shumë pak raste janë analizuar e interpretuar dispozitat nga pikëpamja abstrakte. Gjithashtu provat të cilat janë analizuar, janë analizuar në mënyrë... domethënë u bazuan në prova por pa analizuar provat konkrete të cilat provojnë faktet konkrete në momentin që.. dhe të integrohen provat nëpërmjet ligjit.

Gjithashtu konstatohet që të gjitha vendimet burim vlerësimi, sa i përket kërkesave të cilat kanë qenë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit apo aplikimin e dënimit nën minimum, gjyqtarja është shprehur vetëm mbi konkluzionin se këto pretendime nuk janë të mbështetura, por pa analizuar dispozitat, kuptimin e tyre; duke integruar me provat e lejuara në shqyrtim; por është shprehur vetëm në mënyrën

që këto janë... apo ka cituar dispozitat lidhur me rrethanat lehtësuese, rënduese, por nuk ka marrë në analizë asnjërën nga këto rrethana.

Ndërsa për sa i përket marrjes së analizimit të të gjitha pretendimeve të palëve, relatohet se jo të gjitha pretendimet e palëve, megjithëse në disa vendime, pretendimet e palëve zënë pjesën kryesore të vendimit, pasi janë pasqyruar tek pjesa e parë e vendimmarrjes duke u pasqyruar aty dhe më pas duke mos dhënë në fakt edhe rrethanat e faktit konkret, por këto pretendime nuk janë analizuar të gjitha sipas objektivit të padisë.

Për shembull, në një vendim me objekt marrëdhënie pune, i cili është i vetmi në këtë lloj, gjyqtarja ka pasur për objekt shfuqizimin e një vendimi të OSHE-së; ka kërkuar dëmshpërblimin mbi 12 paga mujore dhe shpërblimin për procedurën, për mosrespektim procedure. Pika e parë, sa i përket shfuqizimit, nuk është analizuar aspak nga gjyqtarja, gjithashtu nuk është analizuar aspak mosrespektimi i procedurës, por është dhënë dispozitivi, është analizuar atë që nuk ka qenë objekt i padisë, mosrespektimi i afatit të njoftimit, i është dhënë shpërblim për mosnjoftim të afatit të njoftimit.

Sa më sipër unë mendoj që në këtë rast gjyqtarja ka tejkaluar objektin e padisë dhe nuk është shprehur për të gjitha kërkimet siç duhet.

Kështu që unë për këtë, ka edhe disa gjëra të tjera, por them që gjyqtarja nuk i merr dhe analizon të gjitha pretendimet e palëve, referuar objektivit të padisë apo kërkimeve në rastet e çështjeve penale, si të prokurorit ashtu edhe të të pandehurit. Gjyqtarja është mjaftuar vetëm në arritjen e konkluzionit të pretendimeve të paraqitura apo kërkesat e paraqitura nga prokurori dhe jo nga i pandehuri, pavarësisht se kush janë kërkesat dhe cilat nga kërkimet duhet të gjejë shprehje në vendimmarrje, në analizë, e cila duhet të gjejë pasqyrim edhe në pjesën e dispozitivit të vendimit. Sa më sipër edhe për këtë tregues propozoj pikëzimin në nivelin “mbi mesatar”, me 15 pikë.

Faleminderit!

***Klodian Kurushi:*** Vetëm për “Aftësitë profesionale”.

***Naureda Llagami:*** “Aftësitë profesionale”.

**Yllka Rupa:** Unë sigurisht që në cilësinë e relatores i përmbahem vlerësimit lidhur me kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtares”. Të gjitha elementët që parashtrori zonja Plaku lidhen me meritat ligjore të vendimit të gjykatës, pra i përkasin një gjykate më të lartë për të vlerësuar në ato elementë që parashtrori zonja Plaku. Kështu që unë mendoj që duke qenë se skema e vlerësimit është një skemë formale e cila mbështetet mbi burimet e vlerësimit, them që të gjitha burimet e vlerësimit dhe analiza e konkluzioneve të dala prej tyre janë në përputhje të plotë me të gjithë treguesit e metodologjisë së vlerësimit. Ishte mirë që në qoftë se ka vendime specifike, të citohen (nëse janë penale ose civile), dhe për këto elementë të dimë nëse është vendim që ka shkuar në gjykatë të apelit, pra që është marrë një vendim nga gjykata e apelit lidhur me vendimin konkret; dhe në qoftë se shtrohen çështje të cilat lidhen me dhënien nga ana e gjyqtares i një mendimi më specifik, unë propozoj që të vijë gjyqtarja vetë dhe të japi opinionin e saj (e parashikon ligji), lidhur me këto kundërshtitë që zonja Plaku ka në kuadër, në respekt edhe të parimit të kontradiktoritetit të shqyrtimit të projektraportit të vlerësimit në seancë dëgjimore.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Diskutimi që në fakt kemi këtu, ardhja apo jo ardhja e gjyqtares, është një propozim që do e vlerësojmë, diskutimi që kemi këtu është mbi vlerësimin e vendimeve, që ajo që të paktën kuptova nga zonja Plaku është që mënyra, metodologjia e vlerësimit të vendimeve konkrete të marra si burim prove, nuk është në qasjen e standardit që ndoshta kemi mbajtur dhe ndoshta ju si relatores keni përcjellë në Këshill.

Kështu që unë do doja zonja Plaku, ose dhe nga relatorja, që e para, kopje të vendimeve ne t’i kishim. Edhe Këshilli, sepse edhe ne duhet të vlerësojmë pjesën e këtyre vendimeve konkretisht si burim vlerësimi, për të parë nivelin dhe më pas, pasi Këshilli të shohë me kujdes këtë pjesë dhe më pas do jetë po Këshilli që do vlerësojë do thërrasim apo jo magjistratin.



Ju zonja Rupa, mbi ato që tha zonja Plaku, çfarë keni konkretisht kundërshtime, se deri tani na e thatë në mënyrë të përgjithshme.

**Yllka Rupa:** Pra unë mendoj që të gjitha elementët që parashtrori zonja Plaku lidhen me meritat ligjore të vendimeve, pra nuk i vlerëson relatori, por i vlerëson një gjykatë më e lartë.

**Naureda Llagami:** Po pra, zonja Plaku foli në detaje.

Kaloi në metodologji zonja Plaku. Me sa kuptova unë, zonja Plaku shkoi në metodologji, dhe tha sipas metodologjisë që ne bëjmë mbi aftësinë e identifikimit të interpretimit të ligjit, magjistratja nuk e ka realizuar, nuk ka kapur atë pjesë të standardit që neve vlerësojmë mbi mesataren, pra shumë mirë. Kështu që në këtë pikë, zonja Rupa, çfarë keni juve për të thënë, sepse juve keni bërë vlerësimin. S'e kemi bërë ne.

**Yllka Rupa:** Dhe unë e kam thënë në raportin e vlerësimit.

**Naureda Llagami:** Mbi atë që parashtrori zonja Plaku, keni?

**Yllka Rupa:** Unë mendoj që interpretimi i ligjit procedural dhe material është shumë i saktë.

**Naureda Llagami:** Në metodologjinë që ju keni aplikuar, me sa kuptova, zonja Plaku tha që ka mangësi të referimit të ligjit.

**Yllka Rupa:** Standardi që mban Këshilli është, edhe në qoftë se nuk citohen dhe i zbaton parimet, atëherë ne kemi mbajtur qëndrim që të mos penalizohet gjyqtari lidhur me një trajtim të tillë.

**Irena Plaku:** Atëherë, për sa i përket metodologjisë, unë absolutisht nuk i kam hyrë zgjidhjes përfundimtare të çështjes.

Sa i përket pretendimit që kjo shikohet nga Gjykata e Lartë dhe meqenëse Gjykata e Lartë ka vendosur lënien në fuqi, një pjesë e vlerësimit nuk është vendimmarrja e Gjykatës së Lartë. Në rast se një vendim është prishur apo lënë në fuqi nga ana e gjykatës, vlerësimi në ndryshim nga vlerësimet e mëparshme që është bërë nga KLD-ja, nuk vlerësohet ky aspekt, por shikohet mënyra e arsytimit të vendimit, pjesët përbërëse të tij sipas rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor dhe çfarë duhet të mbajë një vendim, që të kemi një arsytim të shkëlqyer. Kur ne i japim një vlerësim të shkëlqyer një gjyqtari, duhet t'i referohem të gjithë elementëve të tij përbërës dhe duhet të jetë në nivel të tillë që të evidentohet dhe jo të jetë në një nivel mesatar apo që të ketë mangësi të tilla. Pra unë mendoj që absolutisht nuk i kam hyrë elementëve thelbësorë.

Mund të marrim vendimin gjyqësor, të cilin po e shikojnë edhe dy anëtarët këtu, i cili është një vendim penal. Në fakt gjyqtarja në atë objekt, është tjetër akuza, është tjetër për çfarë është dënuar ën fund.

Dhe mund të marrë një vendim tjetër që e kam më kollaj. Është vendimi i “marrëdhënies së punës”. Mund ta identifikoni. Lexoni objektin, lexoni fundin, dispozitivin.

Mund të lexojmë një vendim tjetër që është “pavlefshmëria e kontratës së shitjes, pasurive të paluajtshme”. Janë cituar të gjitha dispozitat në këtë rast, e thashë edhe unë këtë, tek civilja gjyqtarja citon edhe përmbajtjen e dispozitivit. Jo tek marrëdhënia e punës, por tek ky vendim është cituar përmbajtja, por nuk analizohen elementët. Konkretisht, nuk ka qenë ligji për fitimin e pronësisë me aktin e marrjes së tokës në pronësi, konkretisht me ligjin 7501. Janë cituar dispozitat e Kodit Civil për bashkëpronësinë e familjes bujqësore, por nuk janë analizuar këto dispozita, nuk është dhënë kuptimi, por ka dalë deri në dispozitiv, domethënë ka arritur në konkluzionet. Megjithëse në disa vendime nuk i parashtron rrethanat e faktit por i parashtron ato sipas pretendimeve të palëve, më pas kur fillon analizën, bën një analizë të rrethanave të fakteve të shqyrtuara (tek pjesa e analizës ligjore) dhe më pas citon dispozitat. Në disa

raste unë them që i ka analizuar dhe ka dhënë edhe kuptimin e tyre, por në disa raste nuk ka dhënë. Për sa i përket standardeve, në fakt ne kemi vlerësuar gjyqtarët dhe kur ka pasur mangësi në citimin e përmbajtjes së dispozitave ne i kemi ulur vlerësimin, në kuptimin nuk e kemi vlerësuar në maksimum (maksimalisht) për shkak se përmbajtja e dispozitës në çështjet penale është tepër e rëndësishme, nga ajo identifikohet cilësimi, nga ajo identifikohet për çfarë po e dënon tjetrin dhe çfarë mase dënimi parashikon.

Në citimin e dispozitës, ne kemi vlerësuar... mund të them edhe emrin e gjyqtarit këtu, por që s'është etike.

**Yllka Rupa:** Ju po thoni që në shumicën e rasteve i citon.

Pra ka disa raste në të cilat, ju mendoni që kjo është proporcionale...

Niveli i vlerësimit që ju propozoni për gjyqtaren nuk është proporcionale në lidhje me atë në qoftë se e marrim të mirëqenë që nuk citon disa dispozitat.

**Naureda Llagami:** Të lutem flisni me... (*mikrofon*).

Ju lutem përdorni pak mikrofonin.

**Irena Plaku:** Sipas vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, kur ka thënë për pjesën që “një vendim duhet të jetë i arsyetuar”, një vendim duhet të jetë i arsyetuar për të gjitha palët, jo vetëm për një jurist që njeh ligjin, por i drejtohet, sidomos të dënuarve të cilët nuk kanë njohuri të posaçme të ligjit apo nuk kanë një njohuri kulturore (se po përdor fjalën e pavend në fakt “kulturë”, po e përdor unë në këtë rast), por që nuk i kanë këto njohur ligjore. Normalisht vendimi duhet të jetë i qartë për të gjithë ata që e lexojnë, duke i dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve. Thashë, në vendimmarrjen e saj gjyqtarja nuk ka analizuar asnjëherë pretendimet e palëve, pretendimet e të pandehurit apo të avokatit, por i ka dhënë në një mënyrë të përmbledhur; ka thënë që është e pambështetur, nuk mbështetet, nuk aplikohet neni 53 për uljen e dënimit me dënim, nuk jemi në rastet e pezullimit, dhe kaq. Nuk ka cituar asnjë përmbajtje, nuk ka bërë asnjë analizë të dispozitave.

*Naureda Llagami:* Po zoti Kurushi!

*Klodian Kurushi:* Faleminderit zonja Kryetare!

Pasi dëgjova këtë diskutimin, unë po jap mendimin tim në lidhje me ecurinë se si do veprojmë. E para mendoj që për shkak të konstatimeve ose gjetjeve të bëra prezent në këtë mbledhje nga ana e zonjës Plaku, unë vetë nuk isha i qartë në këtë drejtim: Ju propozuat që nëpërmjet uljes së pikëve, në disa tregues, të uljet edhe niveli i vlerësimit, nga "Shkëlqyeshëm", duhet të ishte "Shumë mirë", apo jo?

Iren, nga "Shkëlqyeshëm", duhet të ishte "Shumë mirë" besoj niveli.

Por, për treguesit që ju i analizuat dhe identifikuat edhe burimet brenda të cilave juve e bazonit propozimin tuaj, nuk gjeta pikët konkrete se sa ju propozoni për çdo tregues.

Ta mbaroj? Ta mbaroj këtë pjesë.

Në mënyrë që edhe ne ta diskutojmë për shembull çfarë propozon; sa mund të jetë niveli i proporcionalitetit të aftësive profesionale të gjyqtarës me propozimin që ju bëni për çdo nëntregues, për "Aftësitë profesionale". Kjo është pjesa e parë. Sepse kjo pastaj në fund fare do të na çojë edhe tek rezultatja, tek përcaktimi i pikëve për treguesin e "Aftësive profesionale" dhe për përcaktimin e nivelit, apo jo, pra nga "Shkëlqyeshëm", të na zbrisë në një nivel tjetër. Meqenëse, juve thatë që unë i kam edhe me shkrim, apo... Ok, më fal. Do ishte mirë, do orientoheshim besoj më shpejt edhe konstatimet të na formalizoheshin. Neve do marrim ndoshta procesverbalin audio të mbledhjes, por do ishte mirë për efekt kohe që të orientoheshim edhe ne në lidhje me gjetjet e konstatuara si dhe me propozimet që ju bëni për nivelin e vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatës. Kjo është pjesa e parë.

E dyta, mendoj që edhe kandidatja, për sa kohë ka një propozim të tillë, mendoj unë, që edhe kandidatja duhet të njoftohet. Pse? -Në funksion të procesit të rregullt. Sepse kandidatja është dakordësuar me këtë projektvendim dhe nuk ka shfaqur asnjë lloj mosdakordësie kundërshtimi ose problemi që ajo mund të na e ngrejë për të na e

36

sqaruar neve këtë pjesë. Nëse do paraqiten, mendimi i koleges për propozimet që ajo i bëri sot në lidhje me nivelet por jo me pikët, nëse do t'i paraqiten edhe kandidates, besoj unë asaj do t'i jepet mundësia për t'u mbrojtur në lidhje me këto konstatime të bëra nga kolegja dhe ne mbase do kishim në bazë më të mirë të dhënash për të dhënë mendimin tonë në një vlerësim më objektiv besoj të kësaj situatë.

Kështu që, propozimi im është të na bëhen të ditura konkretisht konstatimet dhe pikët në çdo rubrikë dhe niveli në fund fare. Këto konstatime t'i bëhen të ditura edhe kandidates me qëllim që t'i jepet mundësia edhe asaj nëse ka dëshirë edhe vullnet, të paraqesë me shkrim konstatimet e veta ose qëndrimin e saj në lidhje me këto gjetje (po themi) ose këto konstatime. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit zoti Kurushi për propozimin.

Unë do shtoja që edhe për Këshillin, i them relatores, të kemi kopje të vendimeve, t'i shpërndajmë për të gjithë anëtarët e Këshillit.

Po është nisur, por s'janë kopjet e vendimeve aty.

Edhe një herë, kopje të vendimeve nga dosja burim vlerësimi.

Pra edhe një kopje të të gjithë vendimeve nga ana e relatores, në mënyrë hard copy t'i përcillet të gjithë anëtarëve, të cilat janë burim vlerësimi, dhe nga ana e zonjës Plaku të përcillen konkretisht, pra mos ta kemi më propozimin diçka të përgjithshme, por ta kemi konkret dhe për secilin vendim që ju keni parashtrime.

Dhe unë bie dakord me zotin Kurushi, seancën e sotshme e shtyjmë për të lënë mundësi që Këshilli, e para i) të rishohë qëndrimin e zonjës Plaku, të formalizuar, domethënë më konkret me gjërat që ajo propozon, dhe e dyta ii) më pas të ftojme edhe zonjën {...}, duke qenë se kemi një opinion ndryshe lidhur me raportin e vlerësimit, për t'i dhënë edhe asaj të drejtën, duke qenë se ajo në fakt ka rënë dakord me çka i ka propozuar relatorja.

Jemi dakord ta lejmë për një seancë tjetër, kur të vlerësohet, pasi të bëhen gati këto materialet?

**Irena Plaku:** Atëherë, unë jam dakord. Unë do t'i bëj me shkrim të gjitha propozimet e mia, do t'i bëj edhe në mënyrë më të detajuar, duke referuar edhe vendimet, se pikët i kam shumë të qarta për t'i bërë që tani, thjesht i thashë për nivele në fillim, pa dashur të zgjatem, por i bëj me shkrim.

Për sa i përket procedurës për të njoftuar gjyqtaren, nuk e di domethënë sepse unë thjesht po shpreh mendimin tim.

**Naureda Llagami:** Kjo është pjesë e vlerësimit të Këshillit në fakt.

**Irena Plaku:** Patjetër!

**Naureda Llagami:** Ne, pasi të vihemi në dijeni, do futemi prapë në plenare. Nëse ne në plenare do futemi pasi t'i kemi këto gjëra me shkrim; vlerësojmë që po, duhet ta ndryshojmë; në këtë moment ne duhet t'i japim mundësi asaj për të dhënë parashtrimet e veta. Ok?

**Irena Plaku:** Në rregull.

**Naureda Llagami:** Atëherë e shtyjmë për një datë tjetër pasi të jemi gati.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 16.05.2024)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, relatore znj. Irena Plaku.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami<sup>4</sup>.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:19.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Gentiana Muçaj</b>  | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>7. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |

<sup>4</sup> Zoti Rusi drejton pikën e pare të rendit të ditës. Më pas mbledhja drejtohet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Llagami.

- |                       |                  |
|-----------------------|------------------|
| <b>8. Alban Toro</b>  | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>9. Yllka Rupa</b>  | <b>(anëtare)</b> |
| <b>10. Emona Muçi</b> | <b>(anëtare)</b> |

**Shënim:** Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Markelian Koça**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Arben Lila, përfaqësues të Projektit EU4Justice.**
- 7. Valbona Bala, eksperte EWMI.**
- 8. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës.**
- 9. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, relatore znj. Irena Plaku.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë tek çështja tjetër që është jo më pak e rëndësishme, bëhet fjalë për vlerësimin e gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016. Relatore është zonja Irena Plaku.



Zonja Plaku shkurtimisht gjetjet e këtij raporti dhe me sa informacion kemi, nuk ka kundërshtime nga ana e zonjës {...}.

***Irena Plaku:*** Faleminderit!

Atëherë, në mënyrë të përmbledhur, po ju parashtroj projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës. Procedura për vlerësimin e saj ka filluar pasi janë dërguar dosja me aktet e vlerësimit. Pas gjetjes së plotësuar të dokumentacionit me vendimin e datës 07.05.2024 është vendosur plotësia e procedurës dhe është vijuar me hartimin e projektraportit të vlerësimit.

Siç u relatua, gjyqtarja është njoftuar për projektraportin dhe shtojcën përkatëse. Nuk ka pasur kundërshtime lidhur me të. Në mënyrë të përmbledhur po shkoj direkt tek analiza e kriterëve të vlerësimit, pasi në pjesën e parë të projektraportit janë analizuar të gjitha dosjet dhe burimet e vendimit.

Tek kriteri i parë “Aftësitë profesionale të gjyqtarës”, “Njohuritë ligjore”, 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtarja në disa vendime ka parashtruar në mënyrë të përmbledhura faktet e çështjes, në fillim të pjesës arsyetuese të vendimit, menjëherë pas paraqitjes së padisë me të cilën pala paditëse i është drejtuar gjykatës, duke i gërshetuar në disa raste me aktet provuese që provojnë faktet konkrete. Ndërsa në disa vendime, konkretisht tek dy çështjet me objekt marrëdhënie pune, tek vendimi me objekt përmbushje detyrimi, tek vendimi me objekt njohje vërtetësi shënimesh, gjyqtarja ka pasqyruar vetëm disa nga faktet e çështjes, konkretisht në lidhje me ekzistencën së marrëdhënies juridike të punës apo të ekzistencës së kontratës, ndërsa faktet e tjera të çështjes janë përshkruar dhe analizuar tek pjesa e analizës juridike.

Tek dy vendimet objekt shpërblim dëmi faktet janë përshkruar siç kanë rezultuar nga hetimi të kryer nga prokuroria apo vendimit të dënimit të gjykatës. Ndërsa në pjesën tjetër të vendimeve burim vlerësimi, gjyqtarja nuk bën përshkrim të fakteve siç kanë rezultuar nga provat por e fillon arsyetimin e vendimit me parashtrimin e pretendimeve

të palëve lidhur me faktet dhe arsyetimin ligjor të pretendimeve të tyre. Në të gjithë këto vendime burim vlerësimi faktet përshkruhen dhe analizohen në raport me njëra tjetrën tek pjesa e analizës, duke i gërshetuar edhe me aktet provuese.

Sa i përket identifikimit të natyrës së çështjes, rezulton se gjyqtarja identifikon dhe përshkruan saktë faktin juridik, i cili jo gjithmonë përshkruhet i plotë nga gjyqtarja në pjesën e parë të pjesës përshkruese- arsyetuese të vendimit. Gjyqtarja krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, përcaktimi i natyrës nuk ka lidhje vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës por lidhet dhe gjithashtu me identifikimin e ligjit të zbatueshëm procedural dhe material në zgjidhjen e çështjes.

Konkretisht rezulton se gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm, pasi në raport me ligjin procedural është më i kufizuar, gjithashtu identifikon dhe ligjet e posaçme.

Në tërësi nga burimet e vlerësimit, rezulton aftësia e gjyqtarës për paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve thelbësore të çështjes të cilat përgjithësisht paraqiten në mënyrë të përmbledhur, duke i integruar në disa raste dhe provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Por këto fakte jo gjithmonë janë përshkruar në pjesën e parë arsyetuese-përshkruese të vendimit, duke u përshkruar dhe analizuar tek pjesa e analizës juridike të çështjes, fakte të cilat nuk janë përshkruar më parë. Në pjesën e analizës, gjyqtarja integron provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor. Ndërsa rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin... .

Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm” është “Mbi mesatare”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

Sa i përket treguesit 1.A.b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, nga burimet e vlerësimit ka rezultuar që gjyqtarja citon dhe interpreton ligjin, interpretim i cili bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Përgjithësisht normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre herë konciz e herë më të detajuar në varësi të kompleksitetit të çështjes.

Konkluzion: Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja përgjithësisht ka shfaqur aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen, interpretim që bëhet si në aspektin abstrakt ashtu edhe në raport me faktet e çështjes dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese të Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton parimet e së drejtës.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket “Arsyetimit ligjor”, konkretisht për treguesin 1.B.a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit, referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve, në komunikimin shkresor me të tretët dhe vendimet përfundimtare është përgjithësisht e qartë dhe e kuptueshme për pjesëmarrësit në proces, si dhe për lexuesin. Termat teknikë janë përdorur në mënyrë korrekte dhe vetëm në rastet kur përdorimi i tyre është i pashmangshëm, duke iu referuar ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që zbatohen mbi marrëdhënien objekt gjykimi. Në referimin e instituteve dhe parimeve të së drejtës gjyqtarja i përmend ato në arsyetim duke i cituar përgjithësisht në gjuhën shqipe, pa krijuar konfuzion për kuptimin e tyre për lexuesin. Nuk evidentohet përdorim i fjalëve që cenojnë integritetin dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Gjyqtarja përgjithësisht përdor të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe (megjithëse nuk përdoren “ë” dhe “ç”), respekton rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës, dhe vendimet janë shkruar përgjithësisht në mënyrë korrekte në aspektin gjuhësor. Në vendimet

burim vlerësimi, konstatohet se jo gjithmonë gjyqtarja përdor rregullat gramatikore në drejtshkrimin e saktë të fjalëve, kryesisht në mospërdorimin e rregullt të shkronjave të mëdha në fillim të fjalisë, në përdorimin e pasaktë të shenjave të pikësimi dhe fillimit të fjalisë në kryeradhën, etj. Konstatohet se pjesa arsyetuese përshkruese fillon gjithmonë me shkronjë të vogël dhe kjo karakteristikë e gjyqtarës shikohet në disa raste edhe në vijim të pjesën përshkruese-analizuese.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare, ndonjëherë të gjata, duke shprehur mendimin përgjithësisht në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme dhe duke organizuar fjalitë në rrjedhë logjike me njëra-tjetrën, por që ndonjëherë qartësia dhe rrjedha e mendimit humbet nga fakti i mosndërtimit të saktë të fjalive, përsëritja dhe nga mungesa e paragrafëve të mirë dallueshëm. Kjo mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve e vështirëson disi rrjedhshmërinë e vendimit, duke humbur në disa raste filli logjik.

Në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, përveç pjesës hyrëse dhe përshkruese-arsyetuese të vendimit, evidentohet se në dispozitivin e vendimit gjyqtarja shprehet në mënyrë të plotë dhe koncize për të gjitha kërkimet e objekti të padisë në rastet e pranimit të saj, për lëshimin e urdhrin të ekzekutiv në paditë e detyrimit, shpenzimet gjyqësore, etj.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja përgjithësisht i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të kuptueshmërisë për lexuesin. Por nuk konstatohet e njëjta rëndësi në drejtim të koncizitetit dhe qartësisë së vendimit, pasi në disa raste konstatohet përdorimi i fjalive tepër të gjatë, në të cilat humbet filli dhe bëhen tepër të lodhshme për një lexues të zakonshëm. Në mungesën e koncizitetit ndikon edhe mospërdorimi i saktë i rregullave gramatikore në ndërtimin e fjalive dhe përsëritja e mendimit në disa pjesë të vendimit.

Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “mbi mesatare” duke e pikëzuar me 12 pikë.

1.B.b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Gjyqtarja në hartimin e vendimit përgjithësisht ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, të cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve në lidhje me themelin e çështjes (jo atyre me natyrë procedurale), identifikimit të ligjit të zbatueshëm, argumentimin ligjor dhe lidhjes së tyre me konkluzionet. Megjithëse konstatohet se gjyqtarja ndjek përgjithësisht një metodologji strukturimi të pjesëve përbërëse të vendimit edhe pse jo në aspektin formal të saj, nuk konstatohet e njëjta metodologji strukturimi tek secili vendim. Në disa vendime burim vlerësimi mungon pasqyrimi i rrethanave të faktin siç kanë rezultuar gjatë gjykimit, të cilat më pas përshkruhen dhe analizohen tek pjesa e analizës apo argumentit logjik mbi faktet e çështjes dhe pretendimet e palëve, duke filluar arsyetimin me pasqyrimin e pretendimeve të palëve, apo dhe me citimin e provave të pasqyruara prej tyre. Gjithashtu, në vendimin me objekt vleftësim dhe caktim mase sigurimi personal, faktet pasqyrohen vetëm sipas përshkrimit të bërë nga organi i prokurorisë për të vijuar më pas me përshkrimin e kërkimeve të prokurorisë me konkluzionet mbi besueshmërinë në ligj të këtyre kërkesave, duke mos bërë një përshkrim të fakteve siç kanë rezultuar nga provat e paraqitura, si dhe duke mos pasqyruar dhe më pas marrë në analizë pretendimet e të pandehurit, si dhe analizën ligjore në raport me këto fakte të çështjes.

Në projektraport janë përshkruar të gjitha pjesët përbërëse të vendimit, me pjesën hyrëse, me pjesën përshkruese —arsyetuese, që siç e thashë nuk është e strukturuar me paragrafë apo me tituj të cilët mund të identifikohen lehtë, por nga përmbajtja e tyre rezultojnë disa rrethana, konkretisht në prezantimin e çështjes (disa elementë domethënë), rrethanat e faktit, pretendimet e palëve, vlerësimi i gjykatës.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi mbi mesatare në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të organizuar të vendimit. Gjyqtarja ndjek përgjithësisht një strukturë sipas këtij rendi: parashtrimi i rrethanave, pretendimet e palëve, analizimin e fakteve dhe të provave të paraqitura, duke e integruar me ligjin e zbatueshëm që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura nga

grykata, ndërsa në disa vendime strukturimi nuk bëhet sipas këtij rendi logjik. Përgjithësisht konstatohet se gjyqtarja strukturon qartë mendimin dhe argumentimin logjik, në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit. Por nuk konstatohet e njëjta aftësi në përshkrimin dhe analizën e fakteve procedurale dhe në paraqitjen e ecuresë procedurale të çështjes, e cila në disa raste është e nevojshme dhe as në përshkrimin dhe analizën e fakteve thelbësore të çështjes.

Për sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtares për këtë tregues është “mbi mesatare” duke e vlerësuar me 8 pikë.

#### 1.B.c. Cilësia e analizës dhe argumentit logjik.

Për këtë tregues, nga tërësia e burimeve të vlerësimit rezulton burimet e vlerësimit në këtë tregues, duke marrë si një e tërë, pa i dhënë peshë secilit prej tyre, rezulton gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Argumentimi për çdo konkluzion të arritur mbi çështjet e analizuar, si në aspektin procedural ashtu edhe në lidhje me themelin, ka në bazë një analizë të detajuar dhe të integruar të provave, interpretim të ligjit të zbatueshëm dhe aplikimin e tij mbi faktin konkret, duke evidentuar qartë marrëdhënien shkak-pasojë dhe mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore mbi një situatë të caktuar. Arsyetimi i vendimeve përgjithësisht është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje pretendimeve dhe kërkimeve të palëve, duke përmbushur standardet e procesit të rregullt ligjor.

Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtares për këtë tregues është shumë e lartë, duke pikëzuar me 25 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin e parë është pikët 90, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

“Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës” (*tek kriteri i dytë*), konkretisht tek “Aftësia organizative”, po filloj me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”.

Nga burimet e vlerësimit ka rezultuar se një vendim ka parashikuar afat ligjor, konkretisht është vendimi burim vlerësimi “vleftësim arrestit dhe caktim i masës së sigurimit” e cila është shqyrtuar brenda afatit 48 orë. Ndërkohë nga vëzhgimi i dosjeve që i përkasin vendimeve burim vlerësimi, ka rezultuar që tre çështje të tjera gjyqtarja ka

marrë në shqyrtim, me aq sa kuptohet nga përmbajtja e procesverbalit dhe kërkesat për sigurim padie apo kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv, të cilat në dy raste rezulton se nga ana e gjyqtarës nuk janë marrë masa për shqyrtimin e tyre brenda afatit ligjor 5-ditor të parashikuar nga neni 609, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile. Nuk mund të themi që kjo ka ndodhur për arsye të tjera, për sa kohë që rezulton që nga momenti që është caktuar... domethënë mosrespektimi i afatit ka filluar nga momenti i caktimit i cili është caktuar nga ana e gjyqtarës tej afatit 5-ditor seanca e parë, ku mund të jetë marrë në shqyrtim ky afat.

Megjithatë referuar tabelës së pikëzimit për këtë tregues, të përcaktuar në rregulloren për metodologjinë e pikëzimit është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një nivel tjetër vlerësimi.

Në lidhje me aspektin sasior ka rezultuar se gjyqtarja ka përfunduar në periudhën 3-vjeçare objekt vlerësimi 1470 çështje, nga të cilat 602 çështje themeli dhe 868 kërkesa, nga të cilat 343 çështje janë masa sigurim personal, mesatarisht 200 çështje në vit, ndërkohë që duhej të shqyrtonte jo më pak se 120 çështje themeli në vit, duke tejkaluar standardin me 67% .

Në tërësi, referuar këtij treguesi, duke referuar i) raportit të çështjeve dhe kërkesave të gjykuara në tejkallim të afatit ligjor, që rezultojnë në masën 50%; (ii) faktin se dy kërkesat që janë shqyrtuar tej afatit 5-ditor që i përkasin fazës së ekzekutimit dhe janë paraqitur së bashku me padinë (iii) ngarkesën e gjyqtarës si relatores gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarja për këtë tregues duhet të vlerësohen me një nivele të ndryshëm se pikëzimi që rezulton nga të dhënat statistikore, duke u pikëzuar me 12 pikë, por kurrsesi nuk duhet të shkojë në një pikëzim maksimal, pasi nuk rezulton se gjithmonë ka marrë masa për shqyrtimin e kërkesave për të cili ligji ka parashikuar afat ligjor, brenda këtyre afateve. Referuar sa më sipër është propozuar pikëzimi me 12 pikë.

2.A.b. Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit ku janë marrë në analizë 10 çështje për të cilat ligji nuk ka parashikuar afat ligjor, për sa kohë që të dhënat statistikore nuk japin një panoramë të qartë të çështjeve të cilat janë shqyrtuar tej standardeve minimale, ka

47

rezultuar se 80% e çështjeve janë jashtë afatit standard minimal. Referuar metodologjisë, kjo përqindje pikëzohet me 1 pikë.

Më pas është bërë edhe një herë analiza e 3 çështjeve burim vlerësimi, ku në disa çështje po të zbresim periudhën e lejes së zakonshme apo kohën e mbartjes së dosjes, ka rezultuar që për 5 çështje, tashmë duke i llogaritur tejkalimet disaditore të papërfillshëm, mund të konsiderohen të shqyrtuara brenda standardit minimal kohor. Referuar sa më sipër, 50% pikëzohet përsëri me 1 pikë.

Megjithatë në rregullore është parashikuar që, në metodologjinë e pikëzimit, përcaktohet që veç analizës matematikore, vlerësuesi duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, për këtë arsye, referuar konkretisht ngarkesës së gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit, është propozuar një pikëzim me 4 pikë.

Konkretisht duke marrë në konsideratë raportin e çështjeve të shqyrtuara tej standardit minimal i cili ka rezultuar 80%, dhe në rast se zbresim 3 çështje të tjera, rezulton 50%; faktorë që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit, të cilat në dosjen e vëzhguar përgjithësisht nuk rezultojnë të jenë shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtares, por lidhen me ecurinë e procesit gjyqësor, respektimin e të drejtave të palëve; treguesin sasior; natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve; Sa më sipër është propozuar rritja e pikëzimit për këtë tregues me tre nivele duke e pikëzuar me 4 pikë.

2.A.c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Edhe për këtë tregues janë marrë në analizë të njëjtët sipas analizës së të dhënave referuar edhe treguesve të mëparshëm, për sa kohë që flasin për kohën mesatare dhe plotësimin e standardeve minimale kohore. Ka rezultuar se të gjitha çështjet burim vlerësimi janë çështje civile dhe koha mesatare e tyre është tejkaluar. Pra rezulton që 100% koha mesatare është tejkaluar. Megjithatë, pasur parasysh se nga burimet e vlerësimit kemi vetëm një kategori dhe kjo është civile e përgjithshme, e cila ka vështirësinë e saj në gjykim, faktin që gjyqtarja ka tejkaluar standardin minimal me 67%, vlerësoj që niveli i vlerësimit duhet të jetë më i lartë se ai që i korrespondon pikëzimit të përcaktuar në tabelën përkatëse, duke e ngritur deri me tre nivele vlerësimi, por gjithsesi nuk justifikohet një pikëzimin maksimal. Gjithashtu, në përcaktimin e këtij vlerësimi,

48



duhet të merren në konsideratë edhe faktin se të 10 çështjet burim vlerësimi i përkasin kategorisë civile me palë kundërshtare, si dhe mungesën e të dhënave për kohëzgjatjen mesatare të gjykimit për kategoritë e tjera të çështjeve të gjykuara nga gjyqtarja. Referuar sa më sipër është propozuar pikëzimi me 4 pikë.

#### 2.A.ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit, konkretisht të llogaritura nga të dhënat që janë pasqyruar si nga gjyqtari në formularin e vetëvlerësimit, po ashtu edhe janë analizuar në raportin e KLGJ-së, për organet e rivlerësimit, dhe ka rezultuar 78.2%, përqindje e cila pikëzohet në fakt me 2 pikë.

Sipas të dhënave statistikore, konstatohet se për periudhën e vlerësimit të gjithë të dhënat statistikore, ka përfunduar 1470 çështje, nga të cilat 602 çështje janë themeli, konkretisht 600 çështje civile të përgjithshme dhe çështje tregtare, 2 çështje penale.

Është llogaritur rendimenti për çdo vit referuar këtyre burimeve të vlerësimit si dhe një vërtetim që ishte bashkëngjitur nga ana e gjyqtares, të lëshuar nga gjykata së bashku me formularin e vlerësimit.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, megjithëse rendimenti ka rezultuar 78.92 %, e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 8 pikë (*me 2 pikë*), duke marrë në analizë të dhënat e tjera që rezultojnë nga burimet e vlerësimit: ngarkesën e gjyqtares si relatorë; faktin që gjatë kësaj periudhe ka gjykuar edhe kërkesa penale në fazën e hetimit, konkretisht “masa sigurimi” rreth 343 çështje, të cilat kërkojnë dhe angazhim më të lartë, për sa kohë që duhet të respektohet afati i gjykimit. Ka rezultuar se ka dhënë rreth 490 vendime në vit, duke e tejkaluar standardin me 67 %; numrin e lartë të çështjeve të reja të regjistruara gjatë vitit 2013-2016 (që kanë rezultuar 2520); është propozuar një nivel i ndryshëm pikëzimi, duke e rritur me tre nivele, dhe në këtë rast duke e pikëzuar me 8 pikë, por jo në nivelin maksimal.

Për sa më sipër vlerësoj se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me 8 pikë.

#### 2.A.d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit.

Nga burimet e vlerësimit ka rezultuar që koha mesatare e arsyetimit të vendimit për të gjitha kategoritë është më e vogël se afati procedural i parashikuar. Konkretisht

për kërkesat penale është 4 ditë dhe për kategorinë “çështje civile” është 8 ditë. Për sa më sipër, duke qenë se ky afat rezultoi më i shkurtër se afati procedural për të gjithë kategoritë e çështjeve, është propozuar pikëzimi me 15 pikë.

2.B. Aftësia e gjyqtarës për të kryer procedurat gjyqësore, konkretisht 2.B.a. Numri i seancave. Megjithëse nga burimet e vlerësimit ka rezultuar që numri i seancave është 8.1 (është shumë i lartë), pasur parasysh të dhënat burim vlerësimi, duke analizuar dosjet, ka rezultuar se gjyqtarja ka mbikëqyrur siç duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve. Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosformimit të trupit gjykues rezulton se seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë të afërt, etj.

Pasur gjithashtu në analizë është marrë edhe ngarkesa e gjyqtarës dhe për sa më sipër është propozuar, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri i seancave ka rezultuar 8.1 që është më i lart se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj është propozuar pikëzimi me 15 pikë.

2.B.b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Gjyqtarja në përgjithësi i ka vënë në lëvizje çështjet, duke caktuar seancën përgatitore nga 1 deri në 5 ditë për caktimin me short, duke iu referuar rregullave të gjykimit të çështjeve civile, por duke mos disponuar me një urdhër apo vendim formal për caktimin e seancës, por është thjesht një shënim. Megjithatë, edhe për këtë tregues, pavarësisht kësaj mangësie e cila vlerësohet se nuk mund të prekë vlerësimin për këtë tregues, gjyqtarja është propozuar të pikëzohet në nivelin maksimal me 20 pikë.

2.C. Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen.

Nga burimet e vlerësimit në tërësi, rezulton se renditja e akteve është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik dhe kronologjik dhe është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal, janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen lehtësisht. Sa më

50

sipër është propozuar se aftësia e saj është shumë e lartë duke e pikëzuar me 5 pikë (2.C.a).

2.C.b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit.

Edhe për këtë tregues aftësia e gjyqtares është vlerësuar shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Atëherë, propozimi për kriterin e dytë të vlerësimit “Aftësia organizative” është pikët 93, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket treguesit të tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, rezulton se për të gjithë këtë kriter, konkretisht etika në punë ka rezultuar shumë e lartë, është propozuar pikëzimi 35 pikë.

Integriteti i gjyqtares ka rezultuar nga burimet e vlerësimit se nuk ka të dhëna që mund të penalizojnë lidhur me këtë tregues, duke qenë se të gjithë gjyqtarët prezumohet që kanë integritet të lartë. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 40 pikë.

Paanësia e gjyqtares - nuk rezulton nga burimet e vlerësimit përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 10 pikë.

Numri tejet i lartë i kërkesave për përjashtim – nga burimet e vlerësimit nuk rezultoi që të kishte kërkesa për përjashtim dhe nga të dhënat statistikore nuk kemi të dhëna për këtë periudhë vlerësimi. Për sa më sipër është propozuar pikëzimi me 15 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin e tretë është 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket kriterit të katërt, 4.A.a. Komunikimi i qartë dhe transparent, ka rezultuar që aftësia e saj është e lartë, është propozuar pikëzimi me 25 pikë. Edhe tek 4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale rezulton se aftësia e gjyqtares është shumë e lartë dhe është propozuar pikëzimi me 15 pikë.

4.B. Aftësia për të bashkëpunuar, me kolegët ashtu edhe me administratën rezulton shumë e lartë dhe për këtë arsye është propozuar pikëzimi në nivelin maksimal për të dy këto tregues.

4.C.a. Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës, ka rezultuar që gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtarja të ketë marrë

pjesë në 8 aktivitete trajnuese, zhvilluar në 14 ditë. Pasur parasysh që është periudha e gradimit ku nuk ka qenë në fuqi ligji “Për statusin e gjyqtarëve” dhe nuk ka pasur një minimum të përcaktuar, dhe ligji i mëparshëm për Shkollën e Magjistraturës përcaktonte vetëm maksimumin në të cilët mund të merrte pjesë, për këtë arsye, edhe pse trajnimi është nën 15 ditë është propozuar pikëzimi me 20 pikë.

Sa i përket 4.C.b. Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët gjatë stazhit profesional ose për trajnimin e gjyqtarëve, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me këtë tregues. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 3 pikë.

4.C.c. Angazhimi i gjyqtarës në veprimtari ndërinstitucionale, edhe për këtë tregues, nuk rezulton angazhimi i gjyqtarës. Për këtë arsye propozohet pikëzimi me 3 pikë.

Sa i përket treguesit 4.C.ç Publikimet ligjore, nuk rezulton edhe për këtë tregues që të ketë publikime ligjore. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 0 pikë.

Atëherë, propozimi për kriterin e katërt është 91 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për secilin kriter është si më poshtë:

Aftësia profesionale e gjyqtarës, 90 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësia organizative, 93 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësia personale dhe angazhimi profesional, 91 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për nivelin e përgjithshëm është 374 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Faleminderit!

*Naureda Llagami*: Shumë faleminderit!

Atëherë, nëse kemi diskutime?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga relatorja.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Gentiana Muçaj:*** Dakord.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Emona Muçi:*** Dakord.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi: Miratimin e raportit të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi për gjyqtaren {...}, për periudhën 2013-2016. Niveli i përgjithshëm i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 16.05.2024)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami<sup>5</sup>.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:19.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Gentiana Muçaj* (anëtare)

<sup>5</sup> Zoti Rusi drejton pikën e parë të rendit të ditës. Më pas mbledhja drejtohet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Llagami.

7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Markelian Koça* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)
11. *Emona Muçi* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Arben Lila, përfaqësues të Projektit EU4Justice.*
7. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
8. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës.*
9. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*(Futet në sallën e mbledhjes anëtarë z. Koça.)*

*Naureda Llagami:* Atëherë, kalojmë pa humbur kohë tek akti i radhës, që ka të bëjë me hapjen e procedurave për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të

55

Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile. Fjalën ia jap zotit Kurushi.

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit zonja Kryetare!

Unë po e përmbledh në mënyrë të shkurtër pasi propozimi sot i këtij projektvendimi është në vazhden e propozimeve që ne kemi bërë dhe miratimit më pas që ka bërë Këshilli në lidhje me pozicionet e reja të krijuara dhe propozimet për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në gjykatat e shkallëve të para.

Relacioni i sotëm që i bashkëngjitet këtij projektvendimi ka në fakt një arsye pse e bëjmë propozimin për të shpallur një vend të lirë në pozicionin në fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Siç dihet gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, znj. {...}, ka paraqitur kërkesën e saj për mbarimin e statusit si magjistratë. Ndodhur në këto kushte, referuar nenit 43 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli ka për detyrë të konstatojë vendet e lira që janë ose që mund të bëhen si pozicione të lira brenda një afati tremujor. Ndodhur në këto kushte është një situatë ku zonja {...} e ka paraqitur kërkesën e parevokueshme të saj, për të hequr dorë nga statusi i magjistratit dhe si rrjedhojë, për të fituar kohë, mundësi si dhe për t’iu përshtatur detyrimit që rrjedh nga neni 43 i ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ne propozojmë në këtë projektvendim “Hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, pozicion që aktualisht e mbante në detyrë zonja Maliqi.

Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Shumë faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Po, edhe një herë fjalën zoti Kurushi.



***Klodian Kurushi:*** Faleminderit zonja Kryetare!

Përfundimisht pra ne propozojmë hapjen e procedurës. Meqenëse ne e kemi lënë në alternativë afatin brenda të cilit kandidatët gjyqtarë të paraqesin kërkesën për procedurën e lëvizjes paralele, unë propozoj si datë datën 30 maj 2024, si data e fundit e paraqitjes së kërkesave. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Shumë faleminderit!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Gentiana Muçaj:*** Dakord.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Markelian Koça:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Emona Muçi:*** Dakord.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile dhe afati i kandidimit është deri më datë 30.05.2024.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 16.05.2024)*

***Pika 6 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami<sup>6</sup>.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:19.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Gentiana Muçaj*** (anëtare)

<sup>6</sup> Zoti Rusi drejton pikën e parë të rendit të ditës. Më pas mbledhja drejtohet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Llagami.

- |                          |                  |
|--------------------------|------------------|
| <b>7. Ridvan Hado</b>    | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>8. Alban Toro</b>     | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>9. Markelian Koça</b> | <b>(anëtare)</b> |
| <b>10. Yllka Rupa</b>    | <b>(anëtare)</b> |
| <b>11. Emona Muçi</b>    | <b>(anëtare)</b> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jastë.**
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Arben Lila, përfaqësues të Projektit EU4Justice.**
- 7. Valbona Bala, eksperte EWMI.**
- 8. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës.**
- 9. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti tjetër që e përmendi, “anticipoi” zoti Kurushi, që ka të bëjë me mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, znj. {...}.

Shkurtimisht fjala për relatorin, z. Toro.

**Alban Toro:** Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 07.05.2024 është depozituar një kërkesë nga znj. {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Znj. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 03.09.1994. Me vendimin nr. {...}, datë 30.03.1995 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Me vendimin nr. 139, datë 28.03.2023 fillon zyrtarisht Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ku nga 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtare pranë kësaj gjykate. Vjetërsia në funksionin e magjistratit është 29 vite.

Në kërkesën e datës 02.05.2024, znj. {...} kërkon të trajtojë kërkesën konform pikës 3 të nenit 65 të ligjit, pra me efekte të përsheptuara dhe e ka dokumentuar me akte bashkëlidhur për shkak të përkujdesjes që do t'i bëjë një familjari të saj i cili ndodhet në kushte kritike për shëndetin. Në këtë kontekst ka paraqitur amnezinë dhe të gjithë kartelat e nevojshme që provojnë motivin e kësaj dorëheqjeje.

Në këto kushte, duke u garantuar për vullnetin e saj nëpërmjet shkresave, nënshkrimit që i ka bërë shkresës dhe paraqitjes që ka bërë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjithashtu duke parë edhe ngarkesën faktike të Gjykatës Elbasan, gjithmonë duke vënë në balancë edhe ekuilibrin e interesit publik me atë privat të gjyqtares, ju propozohet që ky vendim të japë efektet në datën 31.05.2024, për shkak të disa çështjeve emergjente që ka në dorë (për t'i përfunduar ato) dhe njëkohësisht për dorëzimin e detyrës.

Kështu që përfundimisht ju propozohet në projektin e paraqitur të miratoni:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për shkak të dorëheqjes së saj nga ky status.
2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.05.2024.
3. Të përjashtojë znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit zoti Toro!

Atëherë, kalojmë në miratimin e projekt-aktit, nëse s'kemi diskutime nga kolegët.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Gentiana Muçaj:*** Dakord.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Markelian Koça:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Emona Muçi:*** Dakord.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga relatori.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 16.05.2024)*

***Pika 7 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami<sup>7</sup>.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:19.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)

<sup>7</sup> Zoti Rusi drejton pikën e parë të rendit të ditës. Më pas mbledhja drejtohet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Llagami.

- |                          |                  |
|--------------------------|------------------|
| 6. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 7. <i>Ridvan Hado</i>    | <i>(anëtar)</i>  |
| 8. <i>Alban Toro</i>     | <i>(anëtar)</i>  |
| 9. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 10. <i>Yllka Rupa</i>    | <i>(anëtare)</i> |
| 11. <i>Emona Muçi</i>    | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Arben Lila, përfaqësues të Projektit EU4Justice.*
7. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
8. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës.*
9. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me shpalljen e kërkesës për kandidaturat nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë

63

Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurave të komandimit. Konkretisht bëhet fjalë për njësinë e vlerësimit etik dhe veprimtarisë profesionale. Në fakt ky është një tjetër veprim/akt që po merr Këshilli për të fuqizuar Komisionin e Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale, duke qenë se thelbi i të gjithë aktivitetit të Këshillit në këto momente është rritja e performancës së Komisionit, për të bërë të mundur plotësimin e vakancave, çështje që na është adresuar nga të gjithë. Kështu që kjo është një përpjekje tjetër, pavarësisht se Këshilli i ka hapur dhe rihapur dhe nuk e kemi arritur dot të marrim të rekrutojmë ato njerëz. Kjo është një përpjekje tjetër e Këshillit për t'i rekrutuar/komanduar gjyqtarë pranë kësaj njësie. Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Kurushi.

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit zonja Kryetare!

Ju e përmendët dhe unë nuk po e përsëris më tepër veprimtarinë e komisionit të Këshillit për të fuqizuar Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, njësi e cila kontribuon në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve. Për sa kohë ka edhe dy vakanca të tjera aktualisht të lira, ne nën vazhden e propozimeve që kemi bërë disa herë por edhe për ditën e sotme, propozojmë që të hapet gara për kandidatët magjistratë të cilët preferojnë ose do të shprehin interesin për t'u përfshirë në procesin e garës në pozicionet e lira në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Hapja e procedurës, kohëzgjatja, kriteret dhe procedurat e komandimit janë të njëjta si propozime me propozimin e fundit i cili është miratuar nga Këshilli dhe mbi bazën e këtij propozimi kanë ardhur më pas në njësinë e vlerësimit edhe kolegët gjyqtarë.

Kështu që unë nuk po zgjatem më tepër sepse besoj se do jetë një rast i përsëritur, por ftoj kolegët që t'i bashkohen projektvendimit të parashtruar nga ana e Komisionit. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Shumë faleminderit!

Atëherë, thjesht një propozim për afatin e kandidimit. Deri kur?



**Klodian Kurushi:** E kemi lënë opsionale. Unë propozoj datën 30.05.2024, pra dy javë.

**Naureda Llagami:** Kemi diskutime?

**Emona Muçi:** Po! Kam unë një diskutim.

Në lidhje me një nga kriteret e komandimit është edhe eksperiencia në punë si gjyqtar, e cila sipas projektvendimit dhe relacionit bashkëlidhur të sjellë në këtë mbledhje plenare është parashikuar sikurse herën e parë, tre vjet.

**Naureda Llagami:** Jo hera e parë, por të gjithë herët tona.

**Emona Muçi:** Rezultoi që në përpjekjen e parë që Këshilli bëri për të plotësuar vendin vakant në mars të këtij viti, rezultoi që kandidatët ishin vetëm 2 që u plotësuan dhe që kishin, shprehën dëshirën më pak se sa ne hapëm vendet, për shkak se vjetërsia prej 3 vjetësh është një vjetërsi e cila pasohet edhe me një vlerësim dhe ka një mundësi reale që secili prej magistratëve të konkurrojë për lëvizje paralele në Tiranë, në Elbasan, në Durrës. Për t'i ofruar gjyqtarit, për të na ndihmuar, për t'u bërë sa më joshëse, duke mbajtur në vëmendje edhe atë pjesën, domethënë përshkrimin e punës që bën një nëpunës vlerësues, vlerësoj që ky kriter të mos jetë 3 por të jetë 2-vjeçar; dhe nuk janë nëpunësit ata që, të themi, vlerësojnë, por është edhe relatori, është edhe mbledhja plenare. Gjithashtu vlerësoj që edhe afati të mos jetë deri në datë 31 por të shtrihet, të jetë 4-javor; që të kemi mundësi, dhe kandidatët që mund të vijnë, të kenë mundësi që të, dhe t'u krijohet bindja për të ardhur dhe të krijohet edhe dëshira për të ardhur pranë nesh.

Këto ishin dy propozimet e mia. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Zoti Kurushi!

**Klodian Kurushi:** Në lidhje me propozimin e parë, pra për të ulur vjetërsinë e magjistratit, si kriter të vendosur, mendoj që në këtë rast ne nuk kemi bërë gjë tjetër, veçse kemi mbajtur standardin e krijuar tashmë nga Këshilli, që të rekrutohen në njësinë që është po themi një strukturë shumë e rëndësishme e vlerësimit dhe ata bëjnë një punë jashtëzakonisht të rëndësishme në drejtim të përcjelljes së akteve që lidhen me analizën e situatës ku një magjistrat duhet të vlerësohet nga Këshilli, pra bën një prezantim të të gjithë punës së magjistratit. Ndodhur në këto kushte, unë mendoj që afati 3-vjeçar është afati minimal që ne duhet të vendosim si standard minimal për të ofruar magjistratët në atë pozicion, pasi thashë edhe një herë, pozicioni është shumë i rëndësishëm dhe për këtë arsye nuk mendoj që duhet ta ndryshojmë këtë kriter që kemi propozuar ne si Komision.

Ndërsa në lidhje me propozimin e dytë, propozimi i dytë është edhe ky një propozim standard. Po të dojë Këshilli ne mund ta ndryshojmë këtë lloj propozimi, por e kemi bërë vetëm për efekt të shpejtësisë dhe mundësisë së vijimit të veprimtarisë së njësisë e cila do të na duhet për vlerësimin e kolegëve që ne i kemi aktualisht në garë. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Shumë faleminderit z. Kurushi!

Po, zoti Toro!

**Alban Toro:** Në institucionin e komandimit prezumohet që të ketë një shkëmbim eksperiencash midis gjyqtarit që vjen dhe ofron shërbimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor në pozicionin e jomagjistratit dhe në këtë kontekst, për shkak edhe të fushës që ai do të mbulojë, do të përballet me vlerësime që do duhet t'i bëjë kolegëve. E pra, një eksperiencë e vogël natyrisht nuk do të sjelli ndonjë performancë të mirë të këtij subjekti, pra magjistratit në këtë pozicion, kështu që edhe afati vetë 3-vjeçar është afat jashtëzakonisht i ulët. Megjithatë jemi të detyruar duke parë moshën e re të sistemit që mbizotëron tani, jemi të detyruar të kënaqemi edhe me këtë lloj eksperience. Mos harrojmë që për skemën e delegimit, ligji ka përcaktuar një afat minimal 1-vjeçar, që

është të themi një skemë në të cilën gjyqtari ushtron funksionin e gjyqtarit, i deleguar nga Këshilli në gjykata të ndryshme.

Kështu që në këtë kontekst them që kjo eksperiencë trevjeçare e kërkuar është minimale për atë që do t'u kërkohej pastaj jomagjistratit në këtë pozicion pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në lidhje me afatin tjetër që kërkohej të ndryshohej, edhe ai është i pabazuar sepse po synojmë që të mbarojmë procedura të cilat ndërkohej kanë ngelur për shkak vlerësimesh, janë pozicionet e lëvizjes paralele, të ngritjes në detyrë, të cilat vazhdimisht po kërkohej ndihmës (referohen jomagjistratë) për të përmbyllur këto procedura, të cilët do të mundësojnë më pas sistemin e 32 magjistratëve të rinj në sistem, që me tendencën aktuale e shikoj pak si të vështirë për t'u realizuar.

***Emona Muçi:*** Një saktësim.

***Naureda Llagami:*** Po!

***Emona Muçi:*** Atëherë, në lidhje me nëpunësin vlerësues, ai nuk bën vlerësime, ai përpilon vetëm raportet analitike të cilat më pas... projektet, raportin analitik, projektin e bën relatorin dhe më pas është mbledhja e cila përcakton nivelin e vlerësimit të secilit prej gjyqtarëve. Sa për të saktësuar.

***Naureda Llagami:*** Atëherë, lidhur me propozimin e zonjës Muçi, kalojmë në propozimin nëse kemi...

Unë në fakt si kryetare, mendoj se ne duhet të tentojmë edhe një herë me standardet që kemi. Nëse ne vërtetë nuk arrijmë dot që të marrim ato njerëz, atëherë ndoshta Këshilli mund ta peshojë dhe ta mendojmë edhe një herë tjetër.

Sot ne duhet që të bëjmë edhe një thirrje të gjithë trupës gjyqësore, t'ia çojmë shpalljen të gjithë trupës gjyqësore, t'ia çojmë të gjithë gjykatave, ta nxjerrim, ta publikojmë nëpër gjykata dhe bile jam me propozimin që t'ia çojmë çdo gjyqtar,

67

komplet trupës, por jo kryetarëve, por çdo gjyqtari, për ta ndërgjegjësuar trupën mbi nevojën për të pasur nëpunës gjyqësorë, në adresat elektronike individuale. Ndoshta ta tentojmë edhe një herë këtë gjë dhe nëse nuk funksionon, atëherë Këshilli prapë ka mundësi pas dy javësh ta ridiskutojmë ku çalon dhe pse nuk kemi mundësi të rekrutimit. Unë këtë kam si propozim, për ta testuar edhe një herë.

Jemi dakord që ta tentojmë edhe një herë këto dy javë dhe pas dy javëve, nëse me të vërtetë nuk kemi asnjë opsion tjetër, atëherë pastaj edhe ne mund të themi që e tentuam, nuk na erdhën dhe e bëjmë. Dakord?

Pra propozoj që vendimi të kalojë kështu, me idenë që pas dy javëve pastaj mblidhemi prapë, por pasi të ezaurojmë të gjithë mjetet e informimit publik, individual, për të hequr atë merakun tonë. Dakord?

Kalojmë pra, votojmë propozimin e Klodit

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Duke mbajtur në vëmendje sa u diskutua dakord me projektin dhe në një kohë më të mëvonshme, në rast të mospjesëmarrjes së tij, atëherë të rishikohen të gjitha kriteret. Faleminderit!

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, i lë porosi administratës njoftimin individual të të gjithë trupës gjyqësore për hapjen e këtyre dy pozicioneve.

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 16.05.2024)*

***Pika 8 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, të datave: 06.03.2024, 11.03.2024, 13.03.2024, 14.03.2024, 18.03.2024, 19.03.2024 dhe 27.03.2024.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami<sup>8</sup>.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:19.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                  |                                 |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <b><i>1. Naureda Llagami</i></b> | <b><i>(kryetare)</i></b>        |
| <b><i>2. Ilir Rusi</i></b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b><i>3. Klodian Kurushi</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>4. Fatmira Luli</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>5. Irena Plaku</i></b>     | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>6. Gentiana Muçaj</i></b>  | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>7. Ridvan Hado</i></b>     | <b><i>(anëtar)</i></b>          |

<sup>8</sup> Zoti Rusi drejton pikën e parë të rendit të ditës. Më pas mbledhja drejtohet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Llagami.

8. *Alban Toro* (anëtar)  
9. *Markelian Koça* (anëtare)  
10. *Yllka Rupa* (anëtare)  
11. *Emona Muçi* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*  
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*  
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*  
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*  
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*  
6. *Arben Lila, përfaqësues të Projektit EU4Justice.*  
8. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës.*  
9. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, të datave: 06.03.2024, 11.03.2024, 13.03.2024, 14.03.2024, 18.03.2024, 19.03.2024 dhe 27.03.2024.

*Naureda Llagami:* E fundit, kemi procesverbalet.

Ju janë përcjellë nga administrata, nëse keni pas diskutime. Nga ana juaj nuk është komunikuar, kështu që propozoj miratimin e tyre për të vijuar dhe publikimin.

*Ilir Rusi:* Dakord.

*Irena Plaku:* Dakord.

*Gentiana Muçaj:* Dakord.

*Ridvan Hado:* Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord, në lidhje me procesverbalet e datave 06.03.2024, 11.03.2024, 13.03.2024, 14.03.2024, 18.03.2024, 19.03.2024. Në lidhje me procesverbalin e datës 27.03.2024 për shkak të angazhimeve profesionale, nuk kam qenë prezent.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 06.03, 11.03, 13.03, 14.03, 18.03, 19.03 dhe 27.03.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e tyre Kryetarja e Këshillit.

Me kaq po e mbylлим mbledhjen për sot.

Faleminderit për bashkëpunimin.

Mirupafshim!

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**